

THE KOSOVO BANKER

Financimi i ndërmarrjeve
të vogla dhe të mesme në
Kosovë - Përrallë e çmimit
dhe e paragjykimeve

Roli i bankave në zhvillimin
ekonomik

Edukimi bankar, në hap me
zhvillimet



FINANCIMI PËR ZHVILLIM

PËR HERË TË PARË NË KOSOVË PAGUANI TË GJITHA FATURAT ME STARCARD ME KËSTE



KEK



TELEFONI



TAKSAT



REGJISTRIMI I
VETURËS



KOMPANITË
E SIGURIMIT



GJOBAT NË TRAFIK



PAGESAT DOGANORE

VETËM NË DEGËT E TEB-IT



Dhe të gjitha faturat tjera...



TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

teb-kos.com / 038 230 000



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKERS' ASSOCIATION

Banka Ekonomike



BANKA KOMBETARE TREGTARE

BANKA PËR BIZNES
BpB

ProCredit Bank

NLB Prishtina



BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Raiffeisen
BANK

ANËTAR I ASOCIUAR



Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) është zëri i industrisë bankare në Kosovë. SHBK bashkëpunon me Qeverinë, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, mediat dhe opinionin publik, me qëllim të mbështetjes së një industrie të shëndoshë bankare, e cila promovon zhvillimin afatgjatë ekonomik në Kosovë. SHBK lehtëson bashkëpunimin ndërmjet bankave, duke ofruar një platformë të vetme për lobim të përbashkët, si dhe për diskutimin e iniciativave të reja; identifikon dhe infl uencon iniciativat ligjore dhe rregullative; koordinon bashkërendon aktivitete të përbashkëta për bankat, si dhe promovon aktivitetet bankare përpara audiencës së gjerë. Brenda SHBK-së operon Qendra për Trajtime Bankare, e cila ofron trajtime në fushën e bankave dhe të financave.

"The Kosovo Banker" është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Revista botohet dy herë në vit, me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës: Rr. "Bajram Kelmendi", Nr. 15, Prishtinë; 10000, Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;

THE KOSOVO BANKER

IMPRES- SUM

BORDI I DREJTOREVE

Z. Robert Wright -
Kryetar i Bordit,
Raiffeisen Bank
Kosovo

Z. Ilir I. Aliu -
Zv. Kryetar i Bordit,
ProCredit Bank

Z. Lavdim
Koshutova -
NLB Prishtina

Z. Alp Yilmaz - TEB
Bank

Z. Ilir Aliu -
Banka Ekonomike

DREJTORE
EKZEKUTIVE
Znj. Zana Haxha

REDAKTORE
Znj. Saranda
Spahija

LEKTOR
Muhamet Reçica

PËRMBAJTJA

FINANCIMI PËR ZHVILLIM (7-17)

- Editoriali ■ **Financimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë - Përrallë e çmimit dhe e paragjytimeve** ■ Qasja në financa ■ **Roli i bankave në zhvillimin ekonomik** ■ **Financimi dhe zhvillimi në Kosovë** ■ **Drejt rritjes së financimit për zhvillim**

SISTEMI BANKAR (18-24)

- **Korniza Ligjore Bankare** ■ **Shërbimet elektronike dhe e ardhmja e sektorit ban- kar në Kosovë**

KËNDI I EKSPERTËVE (24-26)

- **Lobimi dhe avokimi në Shoqatën e Bankave të Kosovës gjatë vitit 2012** ■ **Aktivitetet dhe kon- tributi i Komitetit të Pa- jtueshmërisë** ■ **Menax- himi i riskut tatimor dhe sistemi ban- kar**

INTERVISTA (28-33)

- **Kosova, Potencial në Rritje për Investime të Bizneseve** ■ **Norma e Interesit Përcaktohet nga Madhësia e Bizne- sit** ■ **Kreditë e biznesit në Kosovë të njëjta me ato në rajon** ■ **Procredit Bank do të vazhdojë të jetë Partner Lider i Bizneseve në Kosovë** ■ **Komponenta e Per- formancës së Kredisë dhe Kolaterali** ■ **Tregu i kredive të biznesit në Kosovë ka një rëndësi të veçantë**

QENDRA E TRAJNIMEVE NË SHBK (35-37)

- **Edukimi Bankar, në Hap me Zhvillimet** ■ **Programi i Certifikimit EFCB (Bazat E Afarizmit Bankar) I Shoqatës Së Bankave të Kosovës - Suksesi i Rëndësishëm në Zbatimin e Pro- gramit të USAID-It për Ndërmarrjet Private në Kosovë**

LAJME (40-41)

- **Kredi me vetëm 7% interes nga Banka Kom- bëtare Tregtare** ■ **BpB – banka e parë në rajon, e cila ka ofruar shërbimin Mobile Banking** ■ **Ino- vacion në tregun ban- kar** ■ **Pagesa e faturave nëpërmes TEB-it**

PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE (42-43)

- **BKT kontribuon për shoqërinë** ■ **Dita Botërore e kursimeve në ProCredit Bank** ■ **ProCredit Bank rregullon parqe në Prizren, Podujevë dhe Gjakovë** ■ **ProCredit Bank mbledh qindra kapakë të plastikës, në ndihmë të njerëzve me aftësi të kufi zuara** ■ **TEB përkrahi kon- ferencën "Fëmijët me autizëm"**

LAJMËT NGA SHBK (44-46)

- **Panairi Financiar 2012** ■ **Takimi rajonal "Child & Youth Finance Interna- tional"** ■ **Konferenca "Tregjet regjionale të kapitalit – mundësi të reja për firmat kosovare"**



11



22



44



FINCA®



TË GJITHA NEVOJAT KREDITORE NË NJË VEND

CALL CENTER 045 999 444

APLIKO ONLINE www.finca-ks.org

KOSOVA



Editorial



BANKA MË E MIRË NË KOSOVË 2012 Shpallur nga The Banker

Për të pestin vit me radhë, The Banker shpërblen ProCredit Bankën me çmimin "Banka më e Mirë në Kosovë".

Këto çmime prestigjioze rikonfirmojnë performancën e shkëlqyer të ProCredit Bankës, si dhe kontributin në zhvillimin e sektorit bankar në vendin tonë.



038 555 555 | 049 555 555
www.procreditbank-kos.com

TË NDERUAR LEXUES,
Mirë se vini në botimin e dytë të revistës së Shoqatës së Bankave të Kosovës, "The Kosovo Banker".

Me zhvillimet e fundit financiare jashtë vendit dhe në Kosovë, financimi dhe kostot që ndërlidhen me financim ishin të diskutuara më shumë se kurrë. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të temave që do të shtjellohen në këtë botim, kemi vendosur të përçendrohemi në temën e financimit për zhvillim. Ka pasur një numër të studimeve, raporteve dhe artikujve në gazeta, të shkruara dhe të përpiluara rreth qasjes në financa, në veçanti temës së financimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Megjithatë, sa i përket interpretimit të përvojave bankare dhe gjetjeve të tyre, shumica e studimeve janë të kufizuara në intervista me përfaqësues të biznesit dhe/ose përfaqësues teknikë të bankave të ndryshme.

Konsiderojmë se informimi i publikut të gjerë rreth qasjes në financa në mjedisin tonë të brendshëm, nga profesionistë që kanë njohuri të thukta për kushtet e përgjithshme të financimit në Kosovë, ka një rëndësi të

veçantë. Prandaj, në këtë botim të revistës ju kemi sjellë një përmbledhje të artikujve nga një sërë profesionistësh të industrisë bankare dhe financiare, të cilët janë drejtpërdrejt të përfshirë në financim si dhe janë lojtarë kryesorë në fushën e financave të vendit. Për më tepër, për të paraqitur një pamje sa më të balancuar të temave, po ashtu ju kemi sjellë artikuj nga akademikë dhe përfaqësues të komunitetit të donatorëve.

Përveç artikujve të financimit për zhvillim, gjithashtu kemi sjellë disa artikuj përmbytësorë për të ardhmen bankare, me fokus të veçantë në bankungun elektronik dhe reduktimin e përdorimit të parasë së gatshme. Për më tepër, ky botim i revistës përmban intervista nga drejtuesit e departamenteve të korporatave nga të gjitha bankat për kriteret dhe kushtet për kredi biznesi.

Në emër të Shoqatës së Bankave të Kosovës do të doja t'i falënderoj të gjithë autorët e artikujve për kontributin e tyre në diskutimet rreth kushteve të financimit në Kosovë.

Gëzuar festat dhe suksese në vitin 2013!



ZANA HAXHA
DREJTORE
EKZEKUTIVE
SHOQATA E BANKAVE
TË KOSOVËS

Financimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë - Përrallë e çmimit dhe e paragjytimeve

Në shikim të parë, bankat në Kosovë janë duke synuar segmentin e NVM-ve. Shumë bankierë në Kosovë do të dëshironin që ata të mund të ofrojnë më shumë kredi për NVM-të. Portofoli i përbashkët i të gjitha kredive bankare është 1.7 miliardë euro, dy të tretat prej të cilit janë kredituar bizneset, kryesisht NVM-të

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) janë vitale për zhvillimin e Kosovës. Ato shtojnë rritje, gjenerojnë punësim, sjellin risi dhe ofrojnë trajnime/zhvillim të aftësive për punonjësit e tyre. Për ilustrim të këtij artikulli, NVM-të nuk përfshijnë ndërmarrjet mikro dhe korporatat e mëdha, p.sh. ndërmarrjet shumë të vogla, të cilat shpesh janë joformale (të paregjistruara), nuk hyjnë në këtë grup, e as korporatat shumë të mëdha. Numri i ndërmarrjeve të regjistruara (rreth 57.000) në Administratën Tatimore të Kosovës shërben si llogaritje e numrit të NVM-ve.

Një mes i humbur?

Nëse sektori i NVM-ve luan një rol të rëndësishëm në ekonomi, atëherë financimi i NVM-ve është i një rëndësie



KOEN WASMUS

KRYESHEF EKZEKUTIV
KEP

vendimtare për stimulimin e rritjes së mëtejshme të sektorit. Megjithatë, në shumë nga ekonomitë në zhvillim, NVM-të janë të injoruar nga sektori financiar. Bankat zakonisht financojnë korporatat e mëdha, sektori mikro-financiar financon sipërmarrësit mikro, gjersa NVM-të ngelin jashtë këtij procesi. Njerëzit shpesh flasin për 'një mes të humbur' për të nxjerrë në pah mungesën e ofrimit të shërbimeve financiare për NVM-të. Sidoqoftë, a është kjo e vërtetë për Kosovën?

Në shikim të parë, bankat në Kosovë janë duke synuar segmentin e NVM-ve. Shumë bankierë në Kosovë do të dëshironin që ata të mund të ofrojnë më shumë kredi për NVM-të. Portofoli i përbashkët i të gjitha kredive bankare është 1.7 miliardë euro, dy të tretat prej të cilit janë kredituar bizneset, kryesisht NVM-të. Vëllimi i kredive për bizneset është duke u rritur nga viti në vit, ashtu sikurse edhe proporcioni kredi/Bruto Produkti i Brendshëm (BPB). Thënë shkurt, kjo nuk duket edhe aq keq!

Ende nuk kam gjetur atë që jam duke e kërkuar

Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj teme, nuk është koha për të qenë të vetëkënaqur. Në fakt, pronarët e bizneseve, akademikët dhe politikëbërësit po-



hojnë se duhet bërë shumë më shumë. Palët e interesit ende ankohen për mungesë të qasjes në financa si dhe për koston e financimit. Sipas mendimit të tyre, normat e interesit të bankave janë shumë të larta.

Dy studime që u bënë rreth kësaj teme theksojnë se në të vërtetë shumë nga barrierat që pengojnë rritjen e NVM-ve dhe financimin dhe/apo uljen e kostove të financimit të NVM-ve janë jashtë ndikimit të bankave komerciale. Studimi i fundit i Riinvest: 'Sektori bankar: ndihmesë apo pengesë' liston 13 gjetje dhe rekomandime, vetëm dy nga të cilat janë të lidhura me bankat komerciale. Gjithashtu, studimi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë 'Qasja e NVM-ve në financa' liston 7 rekomandime kryesore, nga të cilat vetëm një është ndërlidhur në mënyrë të tërthortë me bankat. Rekomandimet kryesore, në të vërtetë, kanë për synim qeverinë dhe Bankën Qendrore për përmirësim të mjedisit afarist dhe, e fundit, por jo më pak e rëndësishme, vetë komunitetin e biznesit. Pra, cilat janë çështjet kryesore në këtë debat? Do t'i listoj tri çështjet kryesore, sipas mendimit tim:

NUMËR 1: Niveli i lartë i joformalitetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Shumë ndërmarrje të regjistruara nuk kanë llogari të duhura të menaxhimit, u shmangen taksave dhe nuk janë në gjendje të paraqesin propozime përmbajtësore për bankat. Përderisa shumica e bankave kanë gjetur mënyra inovative për t'i bërë vetë vlerësimet financiare dhe të rrezikut të NVM-ve (shpesh duke rihartuar komplet pasqyrat financiare), kjo është një detyrë e kushtueshme që rrit koston e kreditimit dhe mund të çojë drejt dekurajimit të bankave që ta kreditojnë më tutje këtë segment.

NUMËR 2: Mungesa e kolateralit dhe zbatimi i mekanizmeve. Përderisa bankat në Kosovë kreditojnë kompanitë, duke u bazuar kryesisht në rrjedhën e tyre të parasë në vend të kolateralit, për shumat e mëdha të huave kolaterali shpesh është i nevojshëm. Sidoqoftë, titujt e bane-save (si burimi më i disponueshëm i kolateralit) nuk janë të regjistruara, gjykatat janë të ngadalshme dhe jo të rregullta në procedurat e përmbarimit. Mungesa e përm-

baruesve privatë pasqyrojnë një kornizë ligjore të pazhvilluar për kreditim.

NUMËR 3: Mungesa e një shumëllojshmërie portofolesh në sektorin financiar. Sektori financiar i Kosovës është i dominuar nga bankat tradicionale komerciale. Portofolet e kombinuara të kompanive të lizing-ut, institucionet financiare jobankare dhe institucionet mikrofinanciare përbëjnë më pak se 10% të aseteve totale. Produktet, siç janë kreditë afatgjata, mund të sigurohen nga fondet kapitale ose bankat investuese, të dyja prej të cilave mungojnë në treg. Përfaqësimi nuk ofrohet fare dhe sektori i bujqësisë është i injoruar në masë të madhe, me një përbërje prej 13% në Bruto Produktin e Brendshëm (BPB), mirëpo me vetëm 3% pjesëmarrje në kreditë bankare.

Çka duhet bërë?

Bizneset duhet të marrin përgjegjësinë e tyre në sigurimin e informacioneve më të sakta për bankat. Do të ishte mirë që detyrimet e tyre tatimore të pasqyrojnë qarkullimin dhe fitimin e vërtetë, gjë që në shumicën e rasteve nuk ndodh.

Qeveria duhet të marrë rol udhëheqës në përmirësimin e kornizës ligjore dhe të ndihmojë ofertën e kolateralit duke siguruar titujt, me ndërtimin e institucioneve të shëndosha për të mundësuar zbatimin e kolateralit në rast të mospagesave/borxheve. Mundësia e themelimit të gjykatave komerciale që merren vetëm me sekuestre të barrës hipotekare, duhet të konsiderohet me shumë seriozitet.

Dhe, e fundit, por jo më pak e rëndësishme, Banka Qendrore duhet të inkurajojë një shumëllojshmëri në sektorin financiar, duke rritur konkurrencën dhe duke kërkuar nga anëtarët e rinj në treg që të sjellin produkte inovative, sektor të fokusuar dhe/apo një larmi të produkteve në treg.

Në përfundim, bankat janë duke bërë pjesën e tyre në sigurimin e financimit të NVM-ve, mirëpo ende ka shumë për t'u bërë. Bizneset, qeveria dhe Banka Qendrore janë të ftuara për veprim për të ndihmuar dhe inkurajuar kreditimin për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Duke bërë këtë, normat e interesit do të zbrisin.

Qasja në financa

Bankat në Kosovë kanë qenë kontribuesit kryesorë në zhvillimin e ekonomisë, duke ofruar kredi për bizneset. Sipas statistikave të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK-ja), nga viti në vit shumat e kreditimit nga bankat janë rritur.

Është një pikëpamje e përgjithshme se bankat në Kosovë nuk janë aktive në kreditim të bizneseve. Kjo pikëpamje është dëgjuar kohët e fundit nga Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM-të) në gjithë Evropën Perëndimore.

Këto pohime i kam studiuar në emër të projektit për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (NVM) të financuar nga Bashkimi Evropian dhe gjetjet e mia i kam prezantuar te ministri i Tregtisë dhe Industrisë, si dhe në Panairin Financiar të organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës (Raporti mund të gjendet në www.smallbusinessdays.com).

Nëse bankat nuk kanë depozita nga konsumatorët, ato nuk mund të financojnë. Bankat në Kosovë janë të rregulluara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe ato mund të financojnë jo më shumë se 80 % të depozitave të klientëve. Shumica e bankave janë në këtë nivel.

Pesë nga gjithë shtatë bankat në Kosovë janë në pronësi të bankave ndërkombëtare. Kompanitë e tyre amë janë subjekt i rregulloreve të vendit të tyre për mjaftueshmërinë e kapitalit (CAR), të cilat kërkojnë rritje të kapitalit. Kjo mund të arrihet ose duke rritur kapitalin, ose duke reduktuar kredidhënien, asetet me rrezik të ponderuar (RWA), apo me një kombinim të të dyjave. Me krizën financiare globale është më e përshtatshme për kompanitë amë të reduktojnë asetet me rrezik të ponderuar (RWA) sesa të tërheqin investitorë të rinj.

'Efekti 'tundues' është se bankat me pronësi ndërkombëtare në Kosovë kërkojnë nga kompanitë e tyre amë që të reduktojnë ose të paktën të mos rrisin asetet me rrezik të ponderuar (RWA), për t'iu ndihmuar atyre të arrijnë nivelet e kërkuara të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Duke pasur parasysh këto kufizime rregullative për rritje të kreditimit, si mund të menaxhojnë bankat porttfoliot e tyre të kreditimit?

Bankat në Kosovë kanë qenë kontribuesit kryesorë në zhvillimin e ekonomisë, duke ofruar kredi për bizneset. Si-



OLIVER WHITTLE

BA (HONS), ACIB,
MCIPD EKSPERT,
PROJEKTI I BASHKIMIT
EVROPIAN PËR
NDËRMARRJE TË
VOGLA DHE TË MESME
(EUSME)

pas statistikave të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK-ja), nga viti në vit shumat e kreditimit nga bankat janë rritur.

Me rënien e ekonomisë botërore, bizneset kosovare janë duke pasur vështirësi për të gjeneruar para si dhe kreditë e këqija kanë pësuar rritje. Për këtë arsye bankat janë duke kërkuar më shumë informacione gjatë vlerësimit të kërkesave për kredi. Bizneset e mesme dhe të mëdha nuk do të duhej të habiteshin nëse atyre tash e tutje iu kërkohej struktura e menaxhmentit, plani i biznesit, pasqyrat financiare të audituara si dhe parashikimet e rrjedhës së parasë, si mbështetje të kërkësve për kredi (për kërkesa të përsëritura apo të reja).

T'i shqyrtojmë këto kërkesa në mënyrë më të detajuar:

1. Struktura menaxhuese

Bizneset që janë duke u rritur duhet të tregojnë se ato janë duke u menaxhuar në mënyrë profesionale. Ditët e biznesit familjar me 'një person' që kontrollon të gjitha aspektet e punës, janë në venitje. Varësisht nga lloji dhe madhësia e biznesit, parashihet që biznesi të ketë një menaxher të operacioneve, menaxher të financave, menaxher të shitjes dhe marketingut, si dhe një drejtor menaxhues dhe që të gjithë këta me kualifikime përkatëse.

2. Plani i biznesit

Vizioni dhe planifikimi paraprak janë thelbësor në mjedisin e sotëm konkurrues. Një plan biznesi duhet të përcaktojë të gjitha informatat në lidhje me biznesin, ku qëndron sot dhe ku do të shkojë në të ardhmen. Planet e rritjes duhet të mbështeten nga hulumtimet e tregut dhe informatat për konkurrencën. Secili anëtar i ekipit menaxhues duhet të përfshihet në zhvillimin e planit të biznesit.

3. Pasqyrat financiare të audituara

Në bazë të Ligjit 04/L-014E mbi Kontabilitetin, Raporti-



min Financiar dhe Auditimin, të datës 29 korrik 2011, parashihet që çdo vit kompanitë të cilat i përmbyshin dy nga tri kriteret e përcaktuara të përpilojnë pasqyrat financiare të audituara nga auditorë të jashtëm.

Kriteret për kompani të mëdha janë:

- a. Qarkullimi vjetor neto më i lartë se € 4 milion
- b. Asetet bruto në datën e bilancit të gjendjes, më të larta se € 2 milion
- c. Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar, më i lartë se 50

Si dhe kriteret për kompani të mesme janë:

- a. Qarkullimi vjetor neto, më i lartë se € 2 milion
- b. Asetet bruto në datën e bilancit të gjendjes, më të larta se € 1 milion
- c. Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar, më i lartë se 10

Përpilimi i pasqyrave financiare të audituara nga kontabilistë të kualifikuar dhe të certifikuar nga SHKÇAK (Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës) apo firmat e kontabilitetit do të pajisin bankën me informata të besueshme financiare që korrespondojnë me dorëzimet tatimore të kompanisë.

4. Parashikimi i rrjedhës së parasë

Me një pikënisje të besueshme të llogarive të audituara dhe bilancit të llogarive bankare si dhe duke përdorur strategjinë dhe planin e biznesit të kompanisë si bazë, menaxheri i financave do të mund të projektojë dy ose tre vjet të parashikimeve financiare si dhe të rrjedhës së parasë.

Nëse të gjitha këto kërkesa plotësohen, ato tregojnë se kompania është serioze, mirë e menaxhuar; ka njohuri për konkurrencën dhe potencialin e vet në treg, si dhe posedon informacione financiare kyçe për të marrë vendime të informuara për çdo kërkesë për financim.

Një tjetër akuzë kundër bankave është se normat e tyre të interesit janë të larta. Kjo edhe mund të jetë e vërtetë, sidoqoftë, normat e interesit krahasuar me disa nga vendet fqinje janë në nivele të ngjashme. Do të ishte më konstruktive, megjithatë, të studiohet pse normat e interesit janë të

larta dhe çfarë mund të bëhet për t'i ulur ato.

Normat e interesit varen nga disa faktorë dhe njëri ndër faktorët kryesorë është kostoja që bartin bankat për mbledhjen e fondeve për kredidhënie.

Burim kryesor i financimit të bankave janë depozitat. Normat e interesit për depozitat në Kosovë janë të larta dhe pasi që shumica e bankave kanë depozita të mjaftueshme për të përmbyshur kërkesat për financim si dhe janë në proporcion me raportin kredi-depozita, të përcaktuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), ka hapësirë që normat e interesit të depozitave të ulen.

Disa banka po ashtu financohen nga huadhënësit e palës së tretë, sikurse IFC – International Finance Corporation (Korporata Ndërkombëtare Financiare, EFSE – European Foundation for Southeastern Europe (Fondacioni Evropian për Evropën Juglindore), etj. Normat e tyre të interesit janë zakonisht më të larta sesa normat që bankat aplikojnë për depozita.

Pra, nëse bankat rrisin numrin e depozitave me normë më të ulët të interesit dhe zvogëlojnë huamarrjen nga kredidhënësit e palës së tretë, do të ketë një reflektim të menjëhershëm në reduktim të normave të interesit në kredidhënie.

Rreziku është faktor tjetër kryesor i normave të interesit. Sa më i lartë rreziku i kreditimit, aq më e lartë norma e interesit.

Pasi që shumica e bizneseve në Kosovë nuk i plotësojnë katër "kërkesat" e renditura më sipër, rreziqet e kreditimit janë të larta. Nëse një banke i duhet dërguar personel për të parë pozitën financiare të kompanisë dhe të kontrollojë në detaje gjendjen aktuale të biznesit, perspektivën dhe nevojat e këtij biznesi në të ardhmen, kjo do të rezultojë në një normë interesi më të lartë të aplikuar për biznesin.

Ka edhe rreziqe të tjera, të tilla si titulli i pronës, vlerësimi dhe çështjet kadastrale të regjistrimit; problemet e regjistrimit të pengut; proceset dhe praktikat tejet të ngadalshme dhe jo të besueshme gjyqësore. Përmirësimet në këto fusha mund të vijnë vetëm nga institucionet qeveritare, duke iu përgjigjur propozimeve të parashtruara nga SHBK (Shoqata e Bankave të Kosovës) si dhe palëve të tjera të interesit. Derisa këto rreziqe të adresohen, normat e interesit do të vazhdojnë të jenë të larta.

Zgjidhja e këtyre çështjeve është në duart e bankave, bizneseve dhe qeverisë

Roli i bankave në zhvillimin ekonomik

Sektori financiar nuk vepron në mënyrë të izoluar në mbështetjen e rritjes së ndërmarrjeve dhe zhvillimit ekonomik.

Edhe pse ende ka debate të vazhdueshme mes akademikëve, hulumtuesve dhe praktikuesve për rolin e drejtpërdrejtë të sektorit financiar në zhvillimin ekonomik të një vendi, ka prova të pakontestueshme të një korrelacioni pozitiv mes të dyjave. Ky artikull është një përpjekje për të ilustruar ndikimin pozitiv të sektorit financiar në Kosovë në zhvillimin ekonomik të vendit. Kur vlerësohet ndikimi i sektorit financiar në zhvillimin ekonomik të Kosovës duhet të shpjegohet se sektori financiar është një nga shtyllat që mbështet këtë zhvillim. Sektori financiar nuk vepron në mënyrë të izoluar në mbështetjen e rritjes së ndërmarrjeve dhe zhvillimit ekonomik. Klima e investimeve në Kosovë që drejton zhvillimin e ndërmarrjeve dhe rritjen ekonomike është e varur nga stabiliteti i përgjithshëm politik dhe makroekonomik i vendit, një kornizë e shëndoshë ligjore dhe sistemi efektiv/ të pavarur të gjyqësorit dhe gjykatave, si dhe një mjedis të matur mikroekonomik që është mbështetës ndaj bizneseve afariste, ku sektori financiar ka shumë për të thënë. Prandaj, për të vlerësuar rolin e sektorit financiar në ekonominë ekzistuese, një kuptim i hollësishëm i strukturave makroekonomike dhe ligjore që mbështesin tërë ekonominë



ERIOLA
BIBOLLI

ZËVENËSDREJTORE
GJENERALE
PROCREDIT BANK

është i nevojshëm. Sidoqoftë, qëllimi i këtij artikulli është ekzaminimi i rolit të sektorit financiar në Kosovë vetëm nga perspektiva e mjedisit mikroekonomik.

Sektori financiar në Kosovë është i dominuar kryesisht nga sektori bankar. Kosova, sot, ka një sektor modern dhe të qëndrueshëm bankar që ofron funksionet themelore të një sistemi modern bankar, siç është paraqitur më poshtë dhe i cili luan një rol kyç në zhvillimin e ndërmarrjeve si dhe rritjen ekonomike.

1) Sektori bankar në Kosovë ofron sisteme moderne dhe efikase të pagesave dhe të shlyerjeve të borxhit, të domosdoshme për kryerjen e transaksioneve ditore nga ana e bizneseve dhe ekonomive familjare. Përveç kësaj, sektori bankar në Kosovë ofron një gamë të gjerë të shërbimeve bankare dhe ka investuar në një infrastrukturë dhe teknologji bashkëkohore bankare në aspektin e pagesave ndërkombëtare, kartelave ndërkombëtare të pagesave, pikave të shitjes, si dhe shërbimeve të tjera elektronike bankare, të cilat ofrojnë banking 24 orësh. Si rrjedhojë e kësaj, sektori bankar ka mundësuar zhvillimin e tregtisë vendëse, ka ndihmuar integrimin e Kosovës në rrjetin ndërkombëtar të pagesave, ka siguruar lëvizjen e lirë të kapitalit në gjithë botën, si dhe ka kontribuar në rritjen e ekonomisë formale.

2) Kanalizimi/drejtimi i burimeve financiare prej depozituesve fillestarë në projekte investuese dhe ndërmarrje.

Sektori bankar në Kosovë ka qenë shumë i suksesshëm në mobilizimin e depozitave fillestare nga ekonomitë familjare të Kosovës, bizneset dhe organizatat, duke promovuar kështu një kulturë të qëndrueshme kursimi. Në të njëjtën

kohë, pjesa më e madhe e këtyre kursimeve është kanalizuar në investimet e brendshme. Si rezultat, Kosova ka një sistem të thjeshtë tradicional bankar, me shumicën e aseteve në kreditë për ndërmarrje. Në fund të shtatorit 2012 kreditë e shpërndara për ndërmarrjet përbënin 67.2% të kredive totale të sektorit bankar në Kosovë. Instrumentet e përdorura nga sektori bankar në Kosovë për shpërndarjen e fondeve në disponim për ndërmarrjet, të cilat janë në rritje, si dhe sektorin privat janë efikase dhe të qëndrueshme.

Sektori bankar në Kosovë, para së gjithash, ka siguruar një qasje të gjerë financimi për ndërmarrjet kosovare. Sektori bankar ka krijuar një rrjet të gjerë të degëve në gjithë territorin e Kosovës, duke siguruar kështu qasje të lehtë në sistemin bankar. Burimet kryesore të financimit në disponim për sektorin privat, të cilat kanë ndikuar në rritjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme janë:

Kreditë me këste të destinuar për investime në asete fikse si dhe investime afatshkurtra të kapitalit punues; mbitërheqjet (overdraft-et) që shërbejnë si instrumente për plotësimin e nevojave afatshkurtra të likuiditetit, si dhe linjat kreditore. Sektori bankar sot ofron shuma relativisht fleksibile të kredive dhe të maturitetit/kohëzgjatjes, duke siguruar kështu një përshtatje adekuate të kredisë me situatën financiare të ndërmarrjes, si dhe me planin e investimeve. Sektori bankar në Kosovë ka financuar projekte dhe sektore të ndryshme të ekonomisë së Kosovës, duke përfshirë tregtinë, shërbimet dhe prodhimin me pakicë. Sa i përket kushteve të kredive të destinuar për asetet fikse, sektori bankar ka dhënë mbështetje të konsiderueshme financiare për procesin e privatizimit në Kosovë, duke financuar një numër të ndryshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat kanë rritur pasuritë e tyre.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i financimit të suksesshëm të sektorit bankar në Kosovë është i lidhur me mbështetjen e projekteve bujqësore. Një numër i madh i fermerëve fillestarë, të vegjël dhe të mesëm ndihmohen me kredi të specializuara për bujqësi, duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë si një nga sektorët strategjik për rritjen e përgjithshme ekonomike. Përveç kësaj, sektori bankar promovon investimet e prodhimeve të vendit. Rritja e prodhimit lokal është e një rëndësie të veçantë për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës dhe ky sektor po ashtu është me rëndësi strategjike për sektorin bankar.

Përveç kësaj, sektori bankar në Kosovë ofron instrumente financiare moderne vendëse dhe ndërkombëtare, siç janë garancitë bankare dhe letër kreditë, të cilat luajnë një rol thelbësor në zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare.

Brenda fushës së financimit në sektorin bankar është e rëndësishme të përmendet se sektori bankar gjithashtu ka siguruar mjete për ekonomitë familjare private në Kosovë. Sektori bankar ka krijuar praktika të sigurta dhe të shëndosha kreditore për ekonomitë familjare, duke dekurajuar kështu praktikatat e kreditimit të tepruar konsumues dhe sh-

mangien e mbingarkimit të klientëve me kredi.

Si rezultat, shuma totale e kredive bankare ndaj bruto produktit të brendshëm në Kosovë ka arritur 40% në fund të shtatorit 2012.

Pavarësisht kontributit të dukshëm të sektorit bankar në ekonominë ekzistuese të Kosovës, sektori mund të bënte më shumë në aspektin e rritjes së efikasitetit të ndërmjetësimit si dhe rritjes së shumave të kredive për sektorin privat. Kjo fushë është sfiduese për vetë sektorin bankar. Së pari, siç u përmend më lart, stabiliteti makroekonomik, reformat e tregut, marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe infrastruktura ligjore janë të domosdoshme për mbështetjen e rritjes ekonomike, paralelisht me përpjekjet e sektorit bankar për të rritur shumën e financimit për ekonominë. Këto përpjekje paralele do të përmirësojnë klimën e investimeve në Kosovë dhe do të stimulojnë kërkesat për kredi investimi, të cilat aktualisht janë të dobëta. Së dyti, një përmirësim në funksionimin e sistemit gjyqësor si dhe në praktikatat e zbatimit të kontratave do të shtojë besimin e bankave në mjedisin e "të bërit biznes" në përgjithësi. Së treti, nga pikëpamja mikro, sektori bankar në Kosovë do të përfitojë më shumë nga një rritje e cilësisë së informacionit të dhënë nga ndërmarrjet. Për të rritur shumën e financimit për ndërmarrjet, një përmirësim në standardet e raportimit financiar të ndërmarrjeve në përputhje me ligjet aktuale në fuqi në Kosovë është esenciale. Përveç kësaj, ngritja e aftësive të ndërmarrësve për të kryer studimet e fizibilitetit dhe analizat e investimeve është po ashtu parakusht. Pa marrë parasysh sfidat, sektori bankar në mënyrë proaktive është duke ofruar mbështetje dhe ndihmë për të adresuar çështjet e përmendura.

Megjithatë, kur flasim për rolin e sektorit bankar në zhvillimin ekonomik të Kosovës, është po ashtu me rëndësi të bëjmë dallimin në zhvillimin cilësor dhe sasior të sektorit bankar. Me gjithë kontributin tradicional në ekonominë ekzistuese, siç është numri dhe shuma e kredive të drejtuara për sektorin privat, sektori bankar ka luajtur një rol të rëndësishëm në ofrimin e trajnimeve të cilësisë së lartë për fuqinë e re punëtore të Kosovës, si dhe rritjen e kapaciteteteve udhëheqëse të menaxhmentit. Sektori bankar ka vendosur një cilësi të lartë të standardeve profesionale për praktikatat e përgjithshme të punësimit dhe zhvillimit të stafit. Për më tepër, sektori bankar ofron një cilësi të lartë të praktikave të menaxhimit të raporteve për klientët e saj.

Përveç kësaj, aktualisht rëndësia e një sektori bankar të qëndrueshëm dhe elastik është thelbësore për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Vitet e fundit kanë treguar se një rezultat i paqëndrueshëm i sektorit bankar shkakton ngadalësim ekonomik. Sektori bankar në Kosovë vazhdon të mbetet mirë i kapitalizuar, me indikatorë të pranueshëm të cilësisë së aseteve dhe mbetet mjaft likuid. Kjo garanton një të ardhme me perspektivë për vetë sektorin bankar dhe po ashtu zhvillimin e ndërmarrjeve, si dhe rritjen e mëtejshme ekonomike të Kosovës.



Financimi dhe zhvillimi në Kosovë

Shumica e faktorëve të diskutuar këtu janë të natyrës institucionale. Prandaj, suksesi në tejkalimin apo zbutjen e këtyre pengesave është i arritshëm nëse ka përpjekje serioze të qeverisë dhe të institucioneve ndërkombëtare në përmirësimin e mjedisit afarist.

Rritja ekonomike në Kosovën e pasluftës ka ardhur kryesisht falë ndihmës së jashtme, remitencave dhe shpenzimeve qeveritare. Secili nga këto tri burime të rritjes ekonomike të vendit karakterizohet nga një paqëndrueshmëri afatmesme dhe afatgjatë. Përdërisa financimi i donatorëve është në rënie e sipër, nuk dihet sa të qëndrueshme do të jenë remitencat në afat të gjatë, kurse shpenzimet publike mbesin të limituara dhe të fokusuara në disa projekte të mëdha kapitale (si për shembull, autostrada). Kjo e avancon zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit privat si një faktor kyç për rritjen dhe zhvillimin e shëndoshë ekonomik të Kosovës vitet në vijim.

Bizneset kosovare në periudhën e pasluftës në vazhdimësi kanë prezantuar pengesat e të bërit biznes, duke rradhitur qasjen në financa si një nga top pengesat për zh-



VENERA
DEMUKAJ

LIGJËRUESE E
EKONOMISË
UNIVERSITETI
AMERIKAN NË KOSOVË

villimin e sektorit privat. Për më tepër, sistemi bankar në Kosovë, sipas tyre, ka treguar një hezitim dhe mosgatishmëri për financimin e disa sektorëve me rëndësi për gjenërimin e rritjes dhe punësimit, si sektorin e bujqësisë, i cili tërheq vetëm 4 % nga portfolio e përgjithshme e kredive. Sistemi bankar po ashtu nuk ka treguar gatishmëri për financimin e bizneseve të reja (business start-ups) duke lënë financimin e këtyre nismave në duart e financave joformale (kredi familjare apo miq).

Në të njëjtën kohë, raporte të ndryshme të institucioneve të vendit dhe ndërkombëtare raportojnë për depozita bankare në rritje, por pa ndonjë ndikim me peshë në koston ende të lartë të financimit për shkak të rrezikut të perceptuar nga bankat. Prandaj, shfrytëzimi sa më i mirë i financave për çlirimin e potencialeve të rritjes ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik paraqet një nga sfidat zhvillimore të Kosovës.

Faktorë të ndryshëm i kanë kontribuar krijimit të kësaj situatë. Këta faktorë përkohë me vetë bankat, por edhe me mjedisin e të bërit biznes. Bankat në Kosovë kanë një qasje konzervative në ofrimin e kredive për shkak të perceptimit të lartë të rrezikut. Ky perceptim i rrezikut vjen kryesisht nga mungesat institucionale që kanë të bëj-

në me mosefikasitetin e gjykatave në zgjidhjen dhe ekzekutimin e rasteve. Të gjitha këto vonesa rrisin shpenzimet e bankave, të cilat pastaj marrin një qasje më konzervative në ofrimin e kredive të bizneseve private, të shprehur nëpërmes normave të larta të interesit, në veçanti për kreditë agrare. Në këtë rrafsh, problem specifik është edhe ekzekutimi i kolateralit, pasi që për arsye të ndryshme, është relativisht e vështirë të gjenden blerës për pengun e paraqitur në treg. Si pasojë e sistemit të dobët gjyqësor në ekzekutimin e kredisë si dhe zbatimit të dobët të kontratave, Kosova radhitet si shtet me normë të lartë të kolateralit në raport me kredinë e lëshuar.

Në anën e bizneseve vërehet në vazhdimësi një deficit i projekteve të financueshme, pasi që një pjesë e tyre nuk kanë mundësi të ofrojnë dokumentacionin e duhur dhe në këtë mënyrë të përmbushin formalitetet e kërkuara për qasje në kredi. Në këtë aspekt, një problem i theksuar veçanërisht për sektorin bujqësor ka të bëjë me mungesën e raportimit, apo raportimin e dobët financiar nga ana e prodhuesve bujqësorë. Kështu, mungesa e informatave ('information asymmetry') rrit edhe më shumë preminë e rrezikut nga ana e sistemit bankar. Një pengesë tjetër trashëguese për bizneset në periudhën e pasluftës ka qenë edhe sistemi i dobët kadastral-mosregjistrimi i tokave dhe ndërtesave të reja dhe rrjedhimisht pamundësia e përdorimit të tyre si peng.

Këto janë disa nga problemet kryesore që pengojnë çlirimin e potencialit financiar në Kosovë në shërbim të një rritjeje dhe zhvillimi më të qëndrueshëm ekonomik. Shumica e faktorëve të diskutuar këtu janë të natyrës in-

stitucionale. Prandaj, suksesi në tejkalimin apo zbutjen e këtyre pengesave është i arritshëm nëse ka përpjekje serioze të qeverisë dhe të institucioneve ndërkombëtare në përmirësimin e mjedisit afarist. Sipas raportit të fundit të Bankës Botërore "Të bërit biznes në Kosovë 2013", komponenta e zbatimit të kontratave nuk ka shënuar progres (nga viti i kaluar, kemi lëvizje vetëm për një vend). Në këtë rrafsh, forcimi i sistemit gjyqësor mbetet prioritet. Po ashtu, shfrytëzimi i mënyrave alternative të zbatimit të kontratave nëpërmes organizmave alternative (Alternative Dispute Settlement) mund të lehtësojë barrën e rënë mbi gjykatat e vendit. Koordinimi më i mirë i institucioneve dhe donatorëve është i domosdoshëm për të arritur një qëndrueshmëri në vazhdimësi të këtyre përpjekjeve, siç është, për shembull, programi trevjeçar nga USAID SEAD me fokus fuqizimin e ligjit për kontratat dhe vendimet gjyqësore, si dhe përdorimin e metodave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Për qasje më të mirë në informata të sakta dhe zbutjen e problemit të asimetrisë së informatave institucionet kosovare, si Banka Qendrore ose ministritë përkatëse po ashtu duhet të përmirësojnë sasinë dhe kualitetin e informatave për regjistrin e bizneseve si dhe historinë në marrjen e kredive.

Këto paraqesin vetëm disa nga mundësitë dhe perspektivat e shumta që do të duhet të adresoheshin për tejkalimin e faktorëve që po rrisin preminë e rrezikut në sistemin financiar. Tejkalimi i këtyre pengesave do të hapte mundësinë për mobilizimin e potencialit ekonomik të Kosovës dhe përafrimin e saj me vendet me nivel më të lartë të rritjes dhe zhvillimit ekonomik

Drejt rritjes së financimit për zhvillim

Shumë ndërmarrje me projekte që mund të financohen nga bankat ende nuk kanë marrë vendim që të formalizojnë aktivitetet e tyre, duke bllokuar kështu qasjen në financim bankar.



JAN-PETER
OLTERS

MENAXHER I ZYRËS SË
BANKËS BOTËRORE
NË KOSOVË

Është matematikë e thjeshtë: nëse Kosova ka sukses në ngritjen e shkallës së rritjes nga 3,3 për qind sa është tash në, të themi, 5 për qind, vendi do të zvogëlojë kohën e nevojshme për të dyfishuar të ardhurat nga 21 vjet e 4 muaj në 14 vjet e 2 muaj. Kjo është një detyrë e vështirë, mirëpo jo e pamundshme, edhe nëse do të nënkuptonte plotësimin e modelit themelor të rritjes – që tash bazohet në remitenca dhe në investime publike – me politika që kanë për qëllim tërheqjen e investimeve të sektorit privat në një shkallë të nevojshme për rritjen e produktivitetit të përgjithshëm. Në këtë ndërmarrje bankat luajnë një rol qendror. Shënimet nga një numër solid i hulumtimeve ekonomike sugjerojnë se ekziston një lidhje kauzale ndërmjet qasjes në kredi dhe rritjes (produktivitetit) të një vendi. Në kontekstin specifik kosovar, ekzistojnë dy pikëpamje të ndryshme për atë se a luajnë bankat një rol të mjaftueshëm aktiv si financuese të zhvillimit apo jo.

Njëra pikëpamje thekson normën e lartë të interesit (përfshirë këtu edhe dallimin pazakonshëm të madh ndërmjet depozitave dhe interesave), vendimet konservatore të kredidhënies, dhe se sektori financiar është i dominuar nga një kuazioligopol i tri bankave të mëdha të huaja. Kjo pikëpamje është konsistente me pohimet (i) se bankat u japin kredi vetëm atyre që marrin paga dhe një numri të kufizuar të ndërmarrjeve që cilësohen si të vlefshme për kreditim, duke lënë kështu sektorë të rëndësishëm të ekonomisë pa ndonjë (ose shumë pak) qasje në financimin bankar; dhe (ii) se nivelet dhe ndryshimet në normat e interesit i tejkalojnë ato që mbizotërojnë në vendet e tjera të Evropës Juglindore. Sigurisht, shënimet e Bankës Qendrore tregojnë se shpërndarja e normës së interesit ka qëndruar në rreth 10 për qind dhe si e tillë në nivele konsiderueshëm

më të larta sesa në vendet fqinje.

Pikëpamja tjetër përshkruan sektorin financiar në Kosovë si sektor që ka qenë jashtëzakonisht shumë i qëndrueshëm ndaj keqësismit dramatik të mjedisit financiar jashtë vendit. Tetë bankat e tij kanë qëndruar mirë me kapital dhe likuiditet. Gjatë gjithë krizës, depozitat dhe kreditë janë rritur gradualisht, ashtu që proporcioni depozit me kredi dhe borxhet e këqija ka ngelur relativisht i vogël. Njëkohësisht bankat kanë ruajtur rregulla adekuate për humbjen në kredi sa u takon kredive të klasifikuara negativisht, që do të thotë se borxhet e këqija kanë pasur një impakt të kufizuar në aftësinë e bankave për të vazhduar ofrimin e kredive për sektorin privat në shkallën e tashme.

Të dy karakterizimet nuk janë kontradiktore, por janë dy anë të së njëjtës monedhë. Si në çdo vend tjetër, institucionet financiare në Kosovë mundohen të bëjnë profit, ato kanë një interes që t'u japin bizneseve dhe amvisërive kredi dhe të shfrytëzojnë përparësinë e diferencës ndërmjet normës së kredisë dhe asaj të depozitave. Proporcioni më i lartë kredi-depozitë – në nivel të njëjtë të rrezikut – nënkupton rritje të profitit, madje në një rrethanë kur ka kërkesa të paprekura për rritje të aktiviteteve kredidhënëse. Vetëm një në dhjetë investimet e sektorit privat në Kosovë është i (bashkë)financuar nga kreditë e bankave, shumica janë të vetëfinancuara.

Në debatin për rolin e bankave në financimin e zhvillimit, pyetja thelbësore ka të bëjë me arsyet përse ato kanë pasur vullnetin të blejnë bonot qeveritare (që nuk mund të përdoren për të plotësuar kërkesën për rezervën minimale) në shkallën prej 2-3 për qind (varësisht nga afati i kthimit), kur njëkohësisht kanë kufizuar kreditë për sektorin privat në norma më të larta se 13 për qind. Një kombinim i tre faktorëve duket se e shpjegon këtë fenomen a priori paradoksal.



Së pari, përderisa sistemet bankare në gjithë Evropën kanë pasur telashe, institucionet financiare në Kosovë, kryesisht të financuara nga depozitat, kanë mbetur profitabile gjatë gjithë krizës. Për këtë arsye ato duket se po mundohen të "qëndrojnë të pavërejtura" për të parandaluar dëmtimin e pasqyrave të tyre të bilancit të gjendjes. Së dyti, shumë ndërmarrje me projekte që mund të financohen nga bankat ende nuk kanë marrë vendim që të formalizojnë aktivitetet e tyre, duke bllokuar kështu qasjen në financim bankar. Së treti, shumë pak projekte janë në fakt të qëndrueshme – pjesërisht për shkak të hipotekave të pamjaftueshme, (perceptimit të) rrezikut të lartë, planeve joadekuate të biznesit, apo niveleve të papranueshme të raportimit financiar.

Në të tre faktorët janë duke ndodhur reforma. Shëndeti strukturor i sektorit financiar, që plotëson politikat e qëndrueshme fiskale, paraqet një përbërës kritik për potencialin zhvillimor socio-ekonomik të Kosovës. Andaj, është shumë e rëndësishme që Banka Qendrore – me profesionalizmin dhe kujdesin e treguar në mbikëqyrjen bankare – të vazhdojë të ushqejë rritjen dhe stabilitetin në sektorin bankar. Kjo do të ndihmonte në forcimin e vetëbesimit të bankave "amë" në aftësinë e degëve të tyre për të qenë profitabile. Krahas kësaj, përmirësimet e fundit në mjedisin e përgjithshëm për të bërë biznes, siç reflektohet në anketën e fundit "Të bërit biznes", e kanë bërë më të lehtë për firmat kalimin në sektorin formal, duke rritur kështu numrin e klientëve potencialë të bankave. Reformat kadastrale në zbatim e sipër – që u mundësojnë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë edhe në sektorin e bujqësisë, të ofrojnë hipoteka për bankat – do të kenë efektin e njëjtë. Nga ana tjetër, masat për përmirësimin e raportimit financiar, auditimit, kontabilitetit dhe njohurive financiare do

ta bëjnë më të lehtë për bankat që të vlerësojnë pasqyrat e firmave, një punë kjo e vështirë në një mjedis me shumë informalitet, duke lejuar kështu që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të demonstrojnë se projektpropozimet e tyre me të vërtetë janë të qëndrueshme. Nëpërmjet projekteve të ndryshme, Banka Botërore po përkrah Kosovën në shumë reforma të ndërlydhura.

Një faktor shtesë që kontribuon në koston për kredi, specifike për Kosovën, kanë qenë normat e larta të interesit që bankat është dashur të paguajnë për depozitat, duke tejkaluar normën e interesave në Eurozonë. Këtu duhet shtruar pyetja se përse sektori privat, sidomos diaspora e Kosovës, nuk e ka shfrytëzuar më mirë këtë situatë. Një arsye duket të jetë besimi i pamjaftueshëm në sigurinë e depozitave. Mirëpo, me themelimin e paradokohshëm të Fondit për sigurimin e depozitave, po ashtu të përkrahur nga Banka Botërore, autoritetet janë munduar të adresojnë këtë pengesë. Tash ekziston një arkitekturë institucionale që krijon një mbulesë që garanton kursimet e rreth 90 për qind të depozitorëve. Kjo do të rrisë edhe më shumë perceptimin e tyre për sigurinë dhe duhet të mundësojë një ndërmjetësim më të thellë financiar që paraqet një indikator të rritjes ekonomike afatgjate.

Një mjedis ekonomik i forcuar hap mundësitë për konkurrencë më të madhe dhe duhet të çojë gradualisht te një ulje e normave të interesit. Meqë pengesat po hiqen, motivet që janë karakteristike për secilën ndërmarrje private do të bindin bankat që të shfrytëzojnë mundësitë për biznes, gjë që do të rezultojë në një konkurrencë më të madhe ndërmjet tyre. Kështu, edhe nëse institucionet financiare janë komode në "ekuilibrin" e tashëm, ato do të futen në një kohë të re dhe më dinamike të financimit të zhvillimit

Korniza Ligjore Bankare

Ligji i ri bankar ka prezantuar një numër të madh të risive. Ky ligj ka adresuar edhe disa nga çështjet të cilat nuk kanë qenë të rregulluara në mënyrë specifike nga rregulloret e mëhershme, si dhe ka trajtuar përmirësimin e kapitalit dhe pozicionin e likuiditetit të bankave.

Industria bankare e Kosovës pas vitit 1999 filloi rimëkëmbjen me themelimin e "Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës" (tani Banka Qendrore e Republikës së Kosovës). Futja e rregullores 1999/21 të UNMIK-ut për Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e bankave ishte korniza rregullative kryesore ligjore për mbikëqyrjen dhe licencimin e bankave. Mbi këtë bazë, janë nxjerrë rregullat dhe rregulloret për rregullimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e bankave. Bazat e kornizës ligjore të asaj kohe mbështeteshin në praktikën më të mira bankare (të asaj kohe), të cilat ishin të përshtatshme për mjedisin e Kosovës si dhe marrëveshja e Bazel I. Kjo kornizë ligjore, me disa ndryshime dhe azhurnime, ishte në fuqi deri në prill të vitit 2012 kur u miratua ligji i ri për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Duke pasur parasysh specifikat e industrisë financiare si një industri e shpejtë në ndryshim e sipër, me një shumëllojshmëri të produkteve dhe ndryshimeve dinamike të mjedisit të jashtëm, nevojitet një kornizë e përshtatshme ligjore, e cila reflekton trendet dhe specifikat e tregut për të promovuar stabilitet financiar. Futja e një kornize të azhurnuar ishte një domosdoshmëri në industrinë e sotme moderne bankare, prandaj marrëveshja Bazel II u arrit dhe u publikua ndërkombëtarisht. Zbatimi i standardeve të Basel II në Bashkimin Evropian u prezantua me nxjerrjen dhe implementimin e Direktivës 2006/48/EC dhe 2006/49/EC, e njohur si CRD - Capital Requirements Directive (apo "Direktiva"), të cilën të gjitha shtetet anëtare të BE-së detyroheshin



GEM MALOKU

UDHËHEQËS I
SEKTORIT TË
MENAXHIMIT TË RISKUT
NLB PRISHTINA

ta përfshijnë në ligjet e tyre kombëtare deri në fund të vitit 2006. Zbatimi i standardeve të Basel II në BE ka filluar më 01 janar 2007, mirëpo përdorimi i metodave të avancuara për llogaritjen e kërkesave kapitale për riskun kreditor dhe riskun operacional, me miratim paraprak të mbikëqyrësve, është mundësuar nga 01 janar 2008. Edhe pse Komiteti kishte parashikuar zbatimin e standardeve të Basel II, të paktën për bankat aktive ndërkombëtare, në Bashkimin Evropian këto u bënë të detyrueshme, nëpërmes direktivave për të gjitha bankat. Një qasje e ndryshme e implementimit të standardeve të Basel II mund të gjendet, për shembull, në Shtetet e Bashkuara, ku përdorimi i saj është i kufizuar vetëm në një numër të vogël të bankave të mëdha, të cilat janë ndërkombëtarisht aktive.

Direktivat e BE-së sollën një strukturë mbikëqyrëse në BE, qëllimi kryesor i së cilës është sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të institucioneve të kreditimit dhe reflektimi i rregullave të Basel II për matje të kapitalit dhe standardeve të kapitalit. Gjersa rregulloret e lartpërmendura të industrisë financiare prezantoheshin në vendet e BE-së dhe në vendet anëtare të marrëveshjes së Bazelit, rregullat dhe rregulloret e Kosovës kanë pasur ndryshime dhe azhurnime të pakta.

Megjithatë, duke pasur parasysh brishtësinë e industrisë dhe krizën e fundit financiare (aktuale që nga viti 2008) në tregjet financiare dhe ekonomitë e vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim, Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Bankare (BCBS) ka finalizuar kornizën e Basel III si përgjigje. Qëllimi i saj kryesor është që të rrisë qëndrueshmërinë e bankave dhe sektorit bankar ndaj goditjeve të papritura dhe të promovojë stabilitet financiar. Nivelet e larta të kapitalit, të kombinuara me një kornizë globale të likuiditetit, do të

redukojnë ndjeshëm probabilitetin dhe ashpërsinë e krizave bankare në të ardhmen. Kërkesat e Basel III do të hyjnë në fuqi nga fillimi i vitit 2013 dhe në mënyrë progresive do të përfundojnë në vitin 2019. Marrëveshjet e përkohshme sigurojnë që Basel III mund të zbatohet në të gjitha vendet pa penguar rimëkëmbjen ekonomike. Të gjitha shtetet në kohë duhet të miratojnë marrëveshjet e Bazel III në ligjet dhe rregulloret e tyre kombëtare, për të pasur një implementim efektiv në vitin 2013.

Në prill të vitit 2012 Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin Nr 04/L-093 MBI BANKAT, INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE. Aktualisht, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka përgatitur projektregulloren për zbatimin e ligjit të lartpërmendur.

NDRYSHIMET KRYESORE TË KORNIZËS SË RE LIGJORE BANKARE

Ligji i ri bankar ka prezantuar një numër të madh të risive. Ky ligj ka adresuar edhe disa nga çështjet të cilat nuk kanë qenë të rregulluara në mënyrë specifike nga rregulloret e mëhershme, si dhe ka trajtuar përmirësimin e kapitalit dhe pozicionin e likuiditetit të bankave.

Fusha të tilla, si qeverisja e korporatave, janë disa nga risitë e këtij ligji. Besohet se disa nga konglomeratet dhe kompanitë më të mëdha të ekonomisë së sotme moderne kanë dështuar për shkak të mospasjes së strukturave të qeverisjes së korporatave në kuadër të këtyre kompanive. Prandaj, një rregullim më i përpiktë i strukturave të qeverisjes së korporatave brenda bankave do të mundësojë stabilitet, transparencë dhe llogaridhënie më të madhe. Ligji i ri përcakton dhe ndan drejtorët e pavarur joekzekutivë nga drejtorët ekzekutivë, rrit numrin e komiteteve në nivel të bordit të punësuar nga drejtorët të pavarur ekzekutivë, si p.sh. komiteti i riskut, pra, thënë shkurt, trajton më saktë teorinë e agjencisë.

Rritja e nivelit të kapitalit fillestar prej 5 milionë euro në 7 milionë euro është një ndryshim tjetër i rëndësishëm i ligjit që do të sjellë një qëndrueshmëri më të madhe të kapitalit, në veçanti për hyrjet e reja në treg. Ngjashëm, mjaftueshmëria e kapitalit si dhe llogaritja e aseteve me risk të ponderuar përfshin disa prej kërkesave të marrëveshjes Basel II, duke përfshirë dhe riskun operacional në kalkulimin e adekuatshmërisë së kapitalit të bazuara në qasjen e standardizuar ose në qasjen e treguesve bazë. Ndonëse tani ekspozimi ndaj riskut të tregut konsiderohet si jomaterial nga Banka Qendrore, rregulloret nuk përfshijnë riskun e tregut në kuadër të llogaritjeve mbi mjaftueshmërinë e kapitalit. Vlen të theksohet se ligji dhe projektregulloret për bankat përfshijnë disa nga kërkesat e marrëveshjes Basel III, të tilla si mjaftueshmëria e kapitalit - raporti proporcional (leverage ratio) dhe likuiditetit, duke përfshirë këtu edhe raportin e mbulimit të likuiditetit (LCR) dhe raportin e fondeve neto të qëndrueshme (NSFR).

Nga pikëpamja e riskut kreditor, ekspozimi maksimal ndaj një klienti ose një grupi të lidhur të klientëve është

ulur nga 20 % në 15 % të kapitalit të klasit të parë (kapitali i klasit të parë definohet sipas rregulloreve në fuqi). Po ashtu, tani është përcaktuar limiti i ekspozimit ndaj palëve të ndërlidhura (personat fizik) me bankën, maksimum deri në 10 % kapitalit të klasit të parë. Ligji tani po ashtu përcakton dhe një kornizën e raportimit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) si një kornizë ligjore të detyrueshme të raportimit, përfshirë këtu dhe përputhshmërinë me rregullat dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës, të cilat janë të ndryshme në matje si dhe njohjen e provizioneve kryesisht për huatë dhe llogaritë e arkëtueshme.

Besohet se futja e ligjit të ri do të nxisë një sektor më të shëndoshë dhe të qëndrueshëm financiar dhe bankar, duke forcuar qeverisjen e institucioneve financiare, kapitalin e anëtarëve (bankave) të reja në treg, monitorim më të përpiktë të pozicionit të kapitalit për bankat ekzistuese dhe po ashtu reduktim të ekspozimit kreditor në një nivel që reflekton qëndrueshmëri të kapitalit të bankave në tregun e Kosovës.

Megjithatë, zbatimi i ligjit do të shoqërohet me ndryshime në treg, kryesisht te bankat me kapital vendës për t'iu përgjigjur kërkesave më strikte të kapitalit, duke rritur kështu detyrimet financiare në përgatitje të burimeve njerëzore dhe miratim të strukturave të teknologjisë së informacionit. Ndërsa, për bankat ndërkombëtare që veprojnë në tregun e Kosovës shumica e kërkesave të ligjit dhe projektregulloret e reja janë tashmë duke u implementuar për shkak të detyrimeve të kompanive të tyre amë ndaj kërkesave të Bankës Qendrore Evropiane, përfshirë këtu edhe raportimin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kjo karakteristikë ka mundësuar monitorim më të avancuar të bankave në Kosovë përdërisa Rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës ishin të bazuara kryesisht në marrëveshjen Bazel I. Prandaj, një pozitë e tillë është një avantazh për industrinë financiare të Kosovës dhe një kontribut indirekt i Bankës Qendrore Evropiane në monitorimin e bankave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Krahasimi i kornizës së re ligjore për bankat dhe institucionet financiare të Kosovës me kornizat ligjore të vendeve në rajon ende nuk mund të konsiderohet si më e avancuara, edhe pse ka pasur progres. Projektregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës reflektojnë kërkesat e marrëveshjes Basel II për përfshirjen e riskut operacional si pjesë të llogaritjeve të mjaftueshmërisë së kapitalit, gjersa kërkesat e marrëveshjes Basel II për riskun kreditor mbeten të përjashtuara. Shumica e vendeve të rajonit (Shqipëria, Maqedonia, Serbia) reflektojnë shumicën e kërkesave të marrëveshjes Basel II për riskun kreditor dhe riskun operacional.

Kërkesat e marrëveshjes Basel III të pasqyruara në draft rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës përfshijnë shumicën e kërkesave për menaxhimin e kapitalit dhe të likuiditetit. Vendet e rajonit po ashtu reflektojnë të gjitha kërkesat e marrëveshjes Basel III në projektregulloret e tyre, me përjashtim të disa prej rregulloreve të Maqedonisë (FYROM), të cilat kanë status përfundimtar

Shërbimet elektronike dhe e ardhmja e sektorit bankar në Kosovë

Sektori bankar në Kosovë ofron një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve për konsumatorët në nivel global. Bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës janë duke bërë investime të rëndësishme për të krijuar infrastrukturë të avancuar teknologjike, e cila ofron shërbime bankare elektronike novatore. Çfarë është reagimi i vërtetë i tregut të shërbimeve bankare ekzistuese elektronike dhe cilat janë sfidat e ardhshme të Kosovës për të nxitur një ekonomi që ka mungesë të hollash.

Gjatë dekadës së fundit, sektori bankar në Republikën e Kosovës ka përjetuar një rritje të qëndrueshme si në asete, po ashtu edhe në klientët të kualifikuar për produkte bankare, gjë që ka çuar në një rritje të vazhdueshme të njohurive dhe kërkesës së tregut për produktet dhe shërbimet bankare. Aktualisht, janë tetë banka komerciale që operojnë në Kosovë, gjashtë prej të cilave janë themeluar me kapital të huaj. Ky kombinim i sektorit ka sjellë risi dhe kreativitet në treg, ku shumica e bankave komerciale ofrojnë një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve duke përdoruar teknologjitë më të avancuara, të cilat ofrohen në nivel global.

Shtrohet pyetja si është duke reaguar tregu ndaj zh-



DUKAGJIN
SHYLEMAJA

ZËVENDËS KRYESHEF
EKZEKUTIV
TEB SH.A.

villimeve aktuale të shërbimeve teknologjike bankare të ofruara nga bankat komerciale?

Aktualisht, numri i përafërt i popullsisë së kualifikuar për produkte bankare në Kosovë është 400.000 dhe 99.6 % e klientëve nga ky grup kanë llogari bankare në një ose më shumë banka. 80.9 % e këtij grupi i përkasin moshës 18-45 vjeç, gjersa 19.1 % i përkasin moshës 46-65 vjeç. Duke u bazuar në këto të dhëna del se popullsia e Kosovës e kualifikuar për produkte bankare është relativisht e re. Nga numri total i popullsisë, 67.2 % janë të punësuar dhe kjo jep numrin nominal prej 268.800 klientësh të kualifikuar për produkte bankare.

Sipas Agjencisë Kosovare të Statistikave dhe Regjistrimit të Popullsisë 2011, numri i përgjithshëm i popullsisë së Kosovës është 1.73 milionë. Kjo shifër tregon se 23 % e popullsisë së përgjithshme ka një llogari në njërin nga bankat komerciale që operon në Republikën e Kosovës. Pjesa dërmuese e popullsisë së përgjithshme të Kosovës është mes moshës 15-64, me një përbërje prej 26 %, gjersa pjesa tjetër është mes moshës 0-14 (28 %) dhe mbi moshën 65-vjeçare (7 %).

Nga të dhënat në dispozicion del se numri ekzistues i popullsisë së kualifikuar për produkte bankare mbulon vetëm 35 % të potencialit të tregut, e cila konsiderohet moshë 15 deri në 64 vjeç. Ky informacion na çon te supozimet sesi mbijeton pjesa tjetër e popullsisë pa përdorimin e shërbimeve të bankave komerciale. Kjo sqaron se 75 % e tregut potencial që nuk i përdorin shërbimet bankare preferojnë 'paratë e gatshme' dhe kjo e klasifikon Kosovën si një ekonomi 'Kesh-i' apo ekonomi e parave të gatshme.

Përdorimi i parave të gatshme ndërlihet me kosto e

Vetëm lëreni të shtohet! Kursimi gradual në NLB



Më në fund një reçetë e duhur për kursim! Për çdo interesë më të larta për çdo vit të kursimit. Në fund, muaj shtoni aq sa e caktoni ju për depozitën tuaj të të ngrohtë u shërbeni të dashurve tuaj. Për të kursimit dhe - vetëm lëreni të shtohet, bashkë me pasur gjithnjë sa më shumë, kurseni – pak nga pak.

NLB  Prishtina

www.nlbprishtina-kos.com



rreziqe të ndryshme dhe është një barrë e vazhdueshme për ekonominë në përgjithësi, (ekonominë informale) dhe subjektet komerciale në veçanti. Pra, do të duhej të ndërmerreshin iniciativa në nivel qeverie, për individët privat apo bizneset, në mënyrë që të zhvillohen politika dhe infrastrukturë e nevojshme për të dekurajuar përdorimin e parave të gatshme.

Shtrohet pyetja se a janë duke kryer bankat pjesën e tyre? Duke e shikuar portofolin ekzistues të produkteve dhe shërbimeve bankare, të cilat janë në dispozicion në treg, Kosova është duke u bërë një model i mirë krahasuar me tregjet rajonale në aspektin e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve bankare moderne, inovative dhe të përshtatshme për klientët. Mirëpo, ende mbetet dobësi kërkesa e konsumatorëve dhe reaksioni ndaj kësaj oferte.

Duke marrë si pasqyrë tregun ekzistues, përqindja e popullsisë së kualifikuar për produkte bankare që përdorin 'Kartelën e Debitit' është përafërsisht 44.7 % dhe nga ky numër 78.4 % e përdorin për tërheqje të parave nga bankomatet e bankave komerciale. Për më tepër, përqindja e popullsisë së kualifikuar për produkte bankare që përdorin 'Kartela Krediti' është rreth 19 %, dhe 8.8 % i përdorin 'Shërbimet Elektronike' (E-banking).

Për të adresuar çështjen e përdorimit të parasë së gatshme në treg dhe shpenzimeve të vazhdueshme të ndërlydhura me këtë fenomen, të kryera nga subjekte të ndryshme publike dhe private, Këshilli Kombëtar i Pagesave i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (KKP) ka filluar një iniciativë për shqyrtimin e opsioneve të mund-

shme dhe projekteve të nevojshme për reduktim të transaksioneve me para të gatshme në Kosovë. Anëtarë të KKP-së janë bankat komerciale, Shoqata e Bankave të Kosovës, Departamenti i Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave dhe përfaqësues të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). Brenda Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) është themeluar një ekip që do të merret me menaxhim të projektit "Reduktimi i transaksioneve me para të gatshme në Kosovë". Ekipi përbëhet nga specialistë të fushave të ndryshme nga bankat komerciale, Banka Qendrore e Kosovës, Shoqata e Bankave të Kosovës, Departamenti i Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave, kompanitë publike, si Postë Telekomit i Kosovës (PTK), Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), kompania Ujësjellësi Rajonal i Kosovës (KUR) Prishtina, si dhe Oda Ekonomike e Kosovës.

Qëllimi i projektit "Reduktimi i transaksioneve me para të gatshme në Kosovë" është shqyrtimi i nxitjes dhe identifikimi i përmirësimeve dhe zhvillimeve të nevojshme për nxitje të transaksioneve bankare mes palëve të interesit në treg, duke analizuar infrastrukturën ekzistuese; kuadrot rregullatore; legjislacionet për pagesat; praktikatat më të mira rajonale ose të vendeve evropiane; legjislacionet evropiane për përdorimin e parave të gatshme dhe sistemit të pagesave; si dhe raportet statistikore, të cilat identifikojnë treguesit kryesorë që kontribuojnë në përdorimin e parave të gatshme në vend të kanaleve alternative.

Në fazën e parë të projektit rezultatet treguan se gjenuesit kryesorë të parave të gatshme në ekonominë tonë

janë bizneset private dhe kompanitë publike. Institucionet qeveritare tanimë kanë zbatuar legjislacionin dhe rregullorët për të dekurajuar ekonominë joformale, e cila lidhet ngushtë me përdorimin e parave të gatshme. Rezultatet janë pozitive dhe trendet janë në përmirësim, por kemi një rrugë të gjatë përpara.

Kompanitë publike me numrin më të madh të konsumatorëve, të cilat gjenerojnë me miliona në vit, qarkullojnë pjesën më të madhe të parave të gatshme në treg. Përveç infrastrukturës bankare dhe alternativave të ndryshme të pagesave elektronike dhe sistemeve të pagesave të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), të dhënat e grupit punues tregojnë se vetëm 6 nga 18 kompanitë publike i janë bashkangjitur dy sistemeve të pagesave të ofruara nga BQK-ja, (Kos-Giro dhe Direct Debit) dhe vetëm 2 nga këto kompani publike (KEK-u dhe PTK-ja) janë duke i përdorur ato në mënyrë aktive. Të dhënat e grupit punues po ashtu tregojnë se rreth 80 % e faturave të kompanive publike paguhen me para të gatshme, ndërsa pjesa tjetër paguajnë brenda në banka komerciale nëpërmjet produkteve Kos-Giro ose Direct Debit (Debitim Direkt).

Në anën tjetër, vetëm 22 % e bizneseve që merren me shitje me pakicë në Kosovë janë të pajisura me ndonjë nga POS terminalat (apo pikat e shitjes) të bankave. Këta indikatorë tregojnë se depërtimi i këtyre produkteve bankare në Kosovë është ende në nivel të ulët, gjë që reflekton sesi alternativë dhe mjet i pagesës në treg ende mbetet 'paraja e gatshme' ('kesh-i').

Për më tepër, është identifikuar se ka një mungesë të vetëdijësimin në mesin e klientëve për metodat e pagesës që ekzistojnë dhe të cilat nuk përfshijnë përdorimin e parave të gatshme. Kartelat elektronike përdoren rrallë (në 59.5 % të rasteve vetëm 1-5 herë në muaj) dhe atë kryesisht për të tërhequr para nga bankomatet (ATM-të). Infrastruktura ekzistuese në bankomate (ATM) dhe pika të shitjes (POS) është në rritje, me një ritëm më të shpejtë sesa rritja mesatare në rajon. Megjithatë, sa i përket bankomateve për 1 milion banorë Kosova aktualisht ka më së paku bankomate në rajon - 5 herë më pak se Sllovenia dhe 2 herë më pak se Maqedonia. Sa i përket pikave të shitjes (POS), Kosova qëndron mirë në krahasim me rajonin. Numri i pagesave me kartela është në rritje, megjithatë Kosova është mbrapa në krahasim me vendet e tjera të Evropës Juglindore dhe Qendrore. Sidoqoftë, Kosova është para Shqipërisë sa i përket numrit të pagesave me kartela për 1 milion banorë.

Një fakt tjetër që është gjetur si kontribues i ekonomisë me para të gatshme është shpërndarja e fondëve pensionale për pensionistët. Bazuar në rregulloret e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) të Kosovës në lidhje me menaxhimin e fondeve pensionale, pagesat mujore të pensioneve të pranuar në llogaritë bankare nga pensionistët duhet të tërhiqen vetëm në para të gatshme. Kjo rregullore nuk lejon asnjë shërbim ose produkt tjetër bankar për pensionistët, përveç tërheqjes së parave të gatshme. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të dhënat e vitit 2007, numri i përgjithshëm i pensionistëve në Kosovë është rreth 131,875. Çdo muaj pensionistët i vizitojnë bankat komerciale për të tërhequr të ardhurat e tyre pensionale, duke i përdorur ato për qëllime të ndryshme, vetëm me para të gatshme.

Duke pasur parasysh fenomenin e përdorimit të parasë së gatshme në Kosovë, kjo temë u diskutua gjerësisht në forumin "E ardhmja bankare", të organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës në Panairin Financiar 2012, ku si fusha kryesore të përmirësimeve u kategorizuan:

- Programet arsimore të trajnimit të klientëve për të dekurajuar pagesat me para të gatshme, duke shpjeguar përfitimet nga shërbimet elektronike,
- Standardizimi i instrumenteve për pagesa,
- Përmirësimi i infrastrukturës teknologjike,
- Përmirësimi i legjislacionit/amendamenteve.

Duke iu referuar fushave të lartpërmendura për përmirësim, një veprim i shpejtë duhet të ndërmerret ndaj kontribuesve të identifikuar si gjenerues të parave të gatshme, për të ndikuar në uljen e këtyre pagesave dhe fushat e përmirësimeve në këtë drejtim janë:

- Standardizimi i faturave të kompanive publike dhe integrimi i tyre në sistemet e pagesave (Kos-Giro, Direkt Debit) dhe POS terminalave (pikave të shitjes).

Referencë e mirë për përmirësimin e sistemit të faturimit për kompanitë publike është platforma elektronike e deklarimit të Taksave dhe Pensioneve e Adminis-

tratës Tatimore të Kosovës. Kjo platformë lejon bizneset të deklarojnë detyrimet e tyre tatimore të herëpashërshme, direkt nga zyra e tyre nëpërmes E-banking ose platformës celulare bankare, pa pasur nevojë që të plotësojnë formularë për t'i kryer pagesat në bankat komerciale.

E njëjta logjikë është duke u zhvilluar edhe nga Dogana e Kosovës, ku në të ardhmen e afërt kompanitë importuese nuk do të kenë nevojë të vizitojnë pikat doganore për t'i kryer detyrimet doganore të mallrave të importuara, por kjo do të mund të bëhet në mënyrë elektronike nëpërmes Internetit.

• Kompanitë publike duhet të konsiderojnë zhvillimin e platformave për gjenerim të faturave elektronike, me ç'rast klientët do të pranojnë faturat elektronike nëpërmjet email adresave ose SMS-ve (mesazheve telefonike) dhe pagesën do të mund ta kryejnë direkt në degë të bankës ose nëpërmjet E-banking apo platformës celulare. Tani për tani kjo metodë e pagesës është duke u përdorur vetëm për kablo ose SMS Top-U

• Bankat duhet të zgjerojnë më tutje rrjetet e tyre të POS terminaleve (pikave të shitjes). Megjithatë, duhet standardizuar dhe adaptuar raportimin e pagesave në pikat e shitjes (përshkrimi i pagesës/informacioni) sipas nevojave të bizneseve dhe institucioneve. Standardizimi i raportimit do të ndihmojë në rritjen e rrjetit të pikave të shitjes dhe numrin e pagesave pa përdorimin e parasë së gatshme në shumë institucione dhe biznese, sikurse: departamentet e regjistrimit të automjeteve, kompanitë e sigurimeve, etj.

• Ofrimi i programeve arsimore për klientët/tregun nga të gjitha palët e interesit. Do të duhej të konsiderohej Programi i Edukimit Financiar i VISA-s i kryer në vende të ndryshme të botës, me qëllim të vetëdijesimit të klientëve për përdorimin e transaksioneve elektronike dhe rëndësi e veçantë gjatë këtyre programeve duhet t'u jepet të rinjve.

• Fushata sensibilizuese që kanë për synim trajnimin e komunitetit të bizneseve në lidhje me shpenzimet që lidhen ngushtë me përdorimin e parave të gatshme dhe alternativat e sistemeve elektronike të pagesave (sistemi i pagesave dhe grumbullimit).

• Zhvillimi i Qendrës Kombëtare për Procesim të Kartelave të Biznesit.

• Rritja e numrit të kartelave bankare; sigurimi i përfitimeve 360 shkallëshe për konsumatorët për të përdorur këto kartela

• Rritja e shërbimeve bankare celulare nëpërmes telefonave 'Smart' (të mençur), që aktualisht kanë përdorim të gjerë në tregjet e zhvilluara për ekzekutim të pagesave, janë potencial i mirë për tregun e Kosovës.

• Korrigjimet në ligjet dhe rregulloret që kanë për synim dekurajimin e përdorimit të parasë së gatshme.

Lobimi dhe avokimi në Shoqatën e Bankave të Kosovës gjatë vitit 2012

Shoqata e Bankave të Kosovës në vitin 2012 ka marrë pjesë në shumë iniciativa legjislative në vend, të cilat kanë pasur për synim rregullimin e sektorit financiar, përkatësisht mjedisin biznesor të sektorit bankar. Gjatë vitit 2012 Shoqata ka marrë pjesë në grupet punuese për hartimin e projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare; projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajshme; projektligjit të pagesave; projektligjit për amendamentimin e ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit; si dhe projektligjit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare.

Shoqata e Bankave të Kosovës ka qenë jo vetëm pjesë e iniciativave për ligjet, por ajo ka marrë pjesë edhe në shumë grupe punuese për draftimin e rregulloreve, kryesisht të përpiluara nga Banka Qendrore e Kosovës, por jo vetëm nga kjo e fundit, me ç'rast Shoqata ka dhënë kontributin tonë nëpërmes ekspertizës bankare. Shoqata ka qenë nismëtare e shumë rregulloreve dhe udhëzimeve për ndryshime, duke sjellë në këtë mënyrë praktikatat më të përshtatshme dhe më të mira për punët e përditshme.

Në vijim ju prezantojmë punën e dy komiteteve gjatë vitit 2012, atë të Komitetit të Pajtuëshmërisë dhe Komitetit të Financave.

Aktivitetet dhe kontributi i Komitetit të Pajtuëshmërisë

Në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës funksionojnë tetë komitete të fushave të ndryshme të sektorit bankar dhe rëndësi të posaçme mes tyre ka edhe Komiteti i Pajtuëshmërisë.

Ky Komitet përbëhet nga ekspertë të fushës së pajtuëshmërisë, prej shtatë bankave komerciale anëtare të shoqatës dhe ka rol këshillues për Shoqatën dhe menaxhmentin e bankave për çështjet që ndërlidhen me pajtuëshmërinë, respektivisht kundër pastrimit të parasë.

Komiteti i Pajtuëshmërisë varësisht nga tema që trajtohet, ka ndër bashkëpunim dhe takime të shumta jo vetëm mes anëtarëve të saj, por edhe me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Qendrën/Njësinë e Inteligjencës Financiare, gjykatat, Agjencinë Anti Korrupsion, Administratën Tatimore, Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfshirë këtu agjencitë, të cilat funksionojnë në kuadër të këtyre ministrive dhe me të gjitha organizatat e tjera që për bazë të aktivitetit të tyre kanë sektorin financiar në Kosovë.

Qëllimi kryesor i Komitetit të Pajtuëshmërisë është të bashkojë kriteret e brendshme të bankave në Kosovë që lidhen me çështjet e pajtuëshmërisë, implementimin e rregulloreve ndërkombëtare për arritjen e kriterëve, duke u bazuar në direktivat e Bashkimit Evropian.

Komiteti ka bashkëpunuar për së afërmi me Bankën Qendrore, me sugjerime dhe komente ndaj legjislacionit sekondar, respektivisht për draft rregulloret e Bankës Qendrore që thirren apo janë të ndërlidhura me Ligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave.

Komiteti i Pajtuëshmërisë bashkëpunon ngushtë edhe me Njësinë e Inteligjencës Financiare (NJIF), në lidhje me mënyrën e zbatimit të Ligjit aktual për parandalimin e shpëlarjes së parave, posaçërisht për obligimet e bankave që dalin nga ky ligj, si dhe njëkohësisht ka dërguar sugjerime/komente të shumta për amendamentimin e Ligjit të ri mbi parandalimin e shpëlarjes së parave.

Në këtë aspekt, Komiteti i Pajtuëshmërisë bashkëpunon edhe me Agjencinë Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me implementimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Aktivitetet e tjera të Komitetit të Pajtuëshmërisë janë të fokusuar po ashtu në ngritjen e vetëdijesimit të institucionit kombëtar për pajtuëshmërinë me udhëzimet e reja të USA - IRS (Internal Revenue Service), respektivisht rregulloret që pritet të hyjnë në fuqi prej 01.01.2013 FATCA - Foreign Account Tax Compliance Act. Kjo rregullore i obligon të gjitha institucionet financiare të nënsh-



KRENAR ÇELA

UDHËHEQËS I
DEPARTAMENTIT TË
PAJTUESHMËRISË NË
RAIFFEISEN BANK
KRYETAR I KOMITETIT TË
PAJTUESHMËRISË NË
SHOQATËN E BANKAVE TË
KOSOVËS

kruajnë një marrëveshje apo të jenë subjekt i ndaljes së tatimit nga SHBA-ja. Nëse institucionet financiare refuzojnë të nënshkruajnë marrëveshjen, institucionet e huaja financiare (FFI-Foreign Financial Institutions) dhe klientët e tyre do të obligohen me 30 për qind ndalje të taksës në gjithë interesin, dividendin dhe të hyrat e shitjes nga të ardhurat e burimit të investimit të SHBA-së. Marrëveshja do të kërkojë nga institucionet e huaja financiare të identifikojnë klientët amerikanë dhe t'i raportojnë ata te Shërbimi i Brendshëm i të Ardhurave (IRS - Internal Revenue Service) në baza vjetore. Mirëpo, gjithsesi për të implementuar këtë rregullore, që pas hyrjes në fuqi do të jete bazë apo kusht për bashkëpunimin bankar ndërkombëtar, do të duhet ndërveprim i shpejtë i Qeverisë së Republikës së Kosovës në drejtim të lidhjes së marrëveshjes me IRS-në, ngjashëm me modelin e aplikuar nga Zvicra apo Japonia.

Në kuadër të Komitetit në takime të ndryshme është diskutuar edhe roli i përgjithshëm i Compliance Officer-it/Zyrtarit të Pajtuëshmërisë në sektorin bankar në Republikën e Kosovës dhe modelet obligative, e që janë të aplikueshme në bankat e Bashkimit Evropian. Në këtë drejtim ka pasur prezantime të ndryshme të organizuara nga Shoqata e Bankave të Kosovës - SHBK, por gjithashtu edhe nga vetë anëtarët e këtij komiteti për funksionimin e rolit të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë jo vetëm në implementimin/pajtuëshmërinë e plotë ndaj Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave, por edhe për funksionimin e mirëfilltë të këtij profili në aspekt të kontrollit të brendshëm, siç është parandalimi i korrupsionit të brendshëm, mashtrimin dhe në përgjithësi në lidhje me kodin e brendshëm të sjelljes.

Përveç tjerash, komiteti po ashtu ka mbajtur takime të shumta me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për të diskutuar Ligjin mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Menaxhimi i riskut tatimor dhe sistemi bankar

Komiteti i Financave në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës është iniciuar vitin e kaluar për arsye praktike. Formimi i këtij komiteti reflekton nevojën e një qasjeje më të koordinuar të sektorit financiar në lidhje me ndryshimet e vazhdueshme të ligjeve, të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në punën e përditshme të bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

Komiteti i Financave përbëhet nga tetë anëtarë (shtatë prej tyre janë përfaqësues të bankave, si dhe një përfaqësues institucioni mikrofinanciar) – udhëheqës të departamenteve të financave. Një nga detyrat kryesore të udhëheqësve të departamenteve të financave në çdo institucion financiar është përgjegjësia e të vepruarit në pajtueshmëri të plotë me obligimet ligjore të shtetit. Në këtë kontekst do të veçoja ligjet që rregullojnë sistemin tatimor. Prandaj, ky komitet i përbashkët është i rëndësishëm.

Edhe përbërja e anëtarëve të komitetit është e një rëndësie të veçantë, sepse mundëson përfaqësim të gjerë dhe dëgjim të vëmendshëm të zërit dhe opinionit të secilit institucion anëtar. Në anën tjetër, përvoja e pasur profesionale e anëtarëve e bën këtë komitet të përshtatshëm për t'i diskutuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet në mjedisin e biznesit.

Për të ilustruar rëndësinë e çështjeve të cilat diskutohen në këtë komitet, fillimisht do të sqaroja një nga rreziqet që duhet menaxhuar në çdo institucion financiar, e ai është menaxhimi i tatimeve.

Sot menaxhimi i tatimeve është pjesë integrale e menaxhimit të riskut, gjë që shpesh quhet menaxhimi i riskut tatimor. Kjo për shkak se jopërputhshmëria me sistemin tatimor rezulton me humbje financiare për çdo institucion që njëkohësisht përmban në vete edhe risk të reputacionit.

Faktorët më të shpeshtë që ndikojnë në vlerësimin e riskut tatimor janë:

- ndryshimet në ligjet e sistemit tatimor,
- ndryshimet në interpretimin e ligjeve tatimore, dhe
- ndryshimet e tjera ligjore.

Kështu roli i udhëheqësve të departamenteve të financave është menaxhimi i suksesshëm i këtyre sfidave.

Si në shtetet e tjera, edhe në Kosovë sistemi bankar është i rregulluar dhe i mbikëqyrur. Si rezultat i mbikëqyrjes efikase nga Banka Qendrore e Kosovës dhe menaxhimit të suksesshëm të bankave, sot Kosova



REZAK FETAI

MENAXHER I LARTË NË
PROCREDIT BANK
KRYETAR I KOMITETIT TË
FINANCAVE NË SHOQATËN
E BANKAVE TË KOSOVËS

mund të krenohet me sistemin e vet stabil financiar.

Mirëpo, nuk duhet harruar se suksesi i një sistemi nuk është diçka që arrihet një herë dhe mbetet i tillë përgjithmonë. Përkundrazi, suksesi i çdo sistemi, përfshirë edhe sistemin bankar, varet nga puna, kujdesi dhe vëmendja e vazhdueshme e të gjithë vendimmarrësve në shoqëri.

Ne besojmë se për të siguruar qëndrueshmëri afatgjate të sistemit bankar nevojitet dialog i vazhdueshëm me të gjitha institucionet shtetërore, të cilat kanë ndikim në mjedisin e biznesit.

Në këtë drejtim, ne si Komitet i Financave kemi kontaktuar me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Administratës Tatimore për ta shpjeguar perspektivën e bankave në lidhje me ndryshimet e shumta dhe të nevojshme që bëhen në sistemin tatimor si dhe për ligjet e tjera. Në këtë kontekst ne jemi të interesuar të ndajmë përvojën tonë me institucionet publike. Tentimet tona për dialog reflektojnë bindjen tonë se një dialog i sqartë mes sektorit privat dhe atij publik është çelësi i çdo suksesi në ekonomi dhe përgjithësisht në shoqëri.

Më duhet të konstatoj se rezultatet e këtyre tentimeve në shumë raste janë sfiduese. Si për shembull, tentimet për të sqaruar efektet e interpretimeve të ligjeve tatimore, të cilat kanë të bëjnë me akrualet e interesit, TVSH-në për kolateralin e shitur, trajtimin e shpenzimeve për edukim dhe trajnim apo për të marrë përgjigje të prera në lidhje me normat ligjore për trajtimin e shumë shpenzimeve që paraqiten gjatë punës së përditshme të bankave. Ne në komitet besojmë se është në interes të përbashkët krijimi i një mjedisi të mirë të biznesit si garanci për zhvillim ekonomik. Kjo është pika fillestare që na bashkon dhe paraqet arsye për të qenë në kontakt të përhershëm me institucionet publike. Pika tjetër është gatishmëria për t'i marrë në konsideratë opinionet dhe idetë e njëri-tjetrit.



Paguaj me kartelë, pa provizion!

Intervista me Udhëheqësit e Departamenteve të Korporatave



KOSOVA, POTENCIAL NË RRITJE PËR INVESTIME TË BIZNESEVE

ALBION MULAKU

DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË KORPORATAVE,
BANKA KOMBËTARE TREGTARE

1) Çfarë nënkuptoni me kreditë për biznes? Për çfarë qëllimi shërbejnë ato?

Kreditë për biznes janë mjete financiare të lëshuara kompanive për qëllime të ndryshme të biznesit, si p.sh.: investim në aktivitetet aktuale të biznesit, zgjerim të biznesit, investim në ndonjë fushë të re të biznesit, përmirësim të likuiditetit financiar, investim në asetet fikse, etj.

2) Cilat kushte duhet të plotësohen për të siguruar një kredi të biznesit?

Informacion që arsyeton lëshimin e kredisë dhe demonstroi aftësinë për shlyerjen e kredisë/borxhit, pasqyra financiare të përgatitura në përpikmëri, raporti i kredive të kompanisë, informacione të përgjithshme për veprimtarinë e kompanisë, etj. janë disa nga kërkesat kryesore. Kompania duhet të jetë e suksesshme dhe duke operuar së paku 18 muaj në treg. Plani i biznesit dhe ndikimi i këtij investimi në aktivitetin e biznesit të klientit në të ardhmen është po ashtu një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm që merret në konsiderim gjatë procesit të miratimit të kredisë.

3) Si ndryshojnë normat e interesit për këto lloje të kredive?

je të kredive? A ekziston mundësia për të ndërhyrë në normën e interesit? Cila është shumica e lejuar për kredi të biznesit (si ndryshojnë ato)?

Në biznesin e korporatave shumica e produkteve i përshtaten klientit dhe kjo është për shkak të natyrës specifike të kompanive që aplikojnë për këto produkte. Ne jemi shumë fleksibil në zbatimin e normave të interesit dhe shumave të kredisë, të cilat ndikohen nga disa faktorë, të tillë si: lloji i biznesit, risku i ndërlidhur me financimin e një sektori specifik, të veçantë, aftësia e kompanisë për të shlyer borxhin, qëllimi i kredisë, historia e kredive, marrëdhënia e klientit me bankën, gama e produkteve të kompanisë, etj. Limiti i shumës së kredisë aplikohet në përputhje me rregulloret e BQK-së për shumën e kapitalit të bankës.

4) Çfarë është e nevojshme të kërkohej për të mbuluar këto kredi? Çfarë lloj pengu (garancie) është i pranueshëm? Si llogaritet rreziku për këto kredi dhe a paraqesin këto rrezik të madh kreditor?

Varësisht nga klienti dhe risku i lidhur me llojin e

produktit (kredisë), peng i luajtshëm dhe i paluajtshëm nevojitet për të mbuluar këto kredi. Në raste të veçanta merret për bazë edhe pengu në formë të hollash. Për shkak të shumës së lartë të këtyre kredive, banka i kushton vëmendje të posaçme pengut dhe risikut kreditor, që llogaritet bazuar në faktorë të ndryshëm që ndërlidhen me biznesin e klientit. Vëmendje e posaçme i kushtohet planit të biznesit të kompanisë, profitabilitetit (fitimit), aseteve, rrjedhës së parasë, qarkullimit, industrisë ku ata vepronë dhe ku janë duke planifikuar të investojnë, menaxhimin dhe përvojën në biznes si dhe faktorë të tjerë të ngjashëm.

5) Si e karakterizoni ju tregun e kredive të biznesit në Kosovë? Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e tregut të kredive të biznesit në Kosovë?

Duke pasur parasysh se Kosova është një treg relativisht i ri bankar, bankat komerciale dhe BQK-ja kanë arritur ta zhvillojnë këtë sektor vazhdimisht, duke e rritur portofolin e kredive, me një numër minimal të kredive jo-performuese në krahasim me rajonin. Kosova

ka potencial në rritje për investime të bizneseve, si vendëse, ashtu edhe të huaja. Shumë sektorë kanë nevojë për investime, zhvillim dhe rritje, prandaj sektori i biznesit ka nevojë të madhe për mbështetje financiare dhe kjo është mundësi e mirë për bankat për t'i mbështetur ato. Megjithatë, për shkak të krizës financiare në Eurozonë, tregu i kredive të biznesit aktualisht është duke u përballur me biznese që tashmë kanë ekspozim të lartë të kredisë dhe shumë rrezikshmëri, prandaj ka vështirësi për t'i mbështetur dhe financuar ato më tutje. Për shkak të këtij ekspozimi të lartë të klientëve ndaj riskut kreditor, bankat janë duke u përballur me rritje të kredive në vonesa. Një aspekt tjetër negativ është funksionimi i sistemit ligjor dhe vonesat me të cilat përballen bankat kur kanë të bëjnë me raste problematike në disa nga gjykatat. Në përgjithësi, sektori bankar në Kosovë konsiderohet si i qëndrueshëm dhe stabil. Ky stabilitet është rezultat i kritereve dhe procedurave të avancuara për vlerësim të kredive, që rrjedhimisht rezultojnë me një cilësi të lartë të portofolit të kredive të biznesit në treg

Kjo rubrikë vjen më afër jush me të vetmin qëllim për të ju informuar më shumë rreth kredive të biznesit, kushteve që duhet plotësuar për kualifikim për këto kredi, normat e aplikueshme të interesit si dhe krahasimi i bërë me rajonin. Të gjitha këto përgjigje i gjeni më poshtë direkt nga kryesuesit e departamenteve të korporatave të bankave komerciale që operojnë në Kosovë, anëtare të Shoqatës së Bankave të Kosovës.



NORMA E INTERESIT PËRCAKTOHET NGA MADHËSIA E BIZNESIT

ARBEN FERRI

UDHËHEQËS I DEPARTAMENTIT TË KORPORATAVE, TEB SH.A.

1) Cilat janë kushtet që duhet plotësuar për tu kualifikuar për marrjen e një kredie të biznesit?

Kushtet të cilat duhet përmbushur për marrjen e një kredie të biznesit janë si vijojnë:
- Kapaciteti i klientit për kthimin e kredisë, ku duhet të merret parasysh plani investiv, kapaciteti ekzistues si dhe kapaciteti shtesë, i cili krijohet me shfrytëzimin e kredisë.

- Historiati i klientit – me të cilën dëshmohej korrektësia e klientit në të kaluarën ndaj institucioneve bankare, si dhe aftësia menaxhuese për sa i përket investimeve.
- Kolaterali - e ka rëndësinë e mbrojtjes në rast të dështimit të planit investiv apo të ndonjë dështimi tjetër. Me këtë mjet nëpërmjet procedurës gjyqësore banka realizon mjetet e veta dhe rikuperon shumën e kredituar.
- Krite ekonomike: sek-

tori ku operon dhe trendet e tij, pozita në treg, rreziku nga hyrje të reja, rreziku nga zëvendësimi i produktit bazë, etj.

2) Si variojnë normat e interesit për këtë lloj të kredive? A ekziston mundësia të ndërhyrë në normën e interesit të aplikuar? Sa është shumica e lejuar e kredive të biznesit (si variojnë ato)?

Në kushte normale norma e interesit është ngushtë e lidhur me riskun e projektit, mirëpo në sektorin bankar norma e interesit përcaktohet nga madhësia e biznesit, ku kreditë e vogla llogariten si më të prirura ndaj moskthimit dhe kanë interes më të lartë, kurse interesi për korporata është më i ulët si rezultat i një baze më të sigurt të klientit të aseteve dhe pozitës në treg. Norma e interesit të aplikuar zbatohet deri në fund të afatit të kredisë

dhe rinegociohet gjatë vazhdimëve në bazë të kushteve të përcaktuara nga banka. Shuma e lejuar e kredive të biznesit i adaptohet madhësisë së biznesit (aseteve, shitjeve, net profitit), në mënyrë që të plotësojë kriterin e kapacitetit të cekur më lart.

3) Çka kërkohet për mbulesë të këtyre kredive? Çfarë lloj kolaterali është i pranueshëm? Si kalkullohet risku për këto kredi dhe a përbëjnë këto kredi risk të madh?

Kreditë e biznesit duhet të jenë të mbuluara me kolateral të natyrës të ndryshme, në varësi të shumës. Për kredi më të vogla deri në 20 mijë pranohet peng i luajtshëm në cilësinë e mallit, pajisjeve dhe veturave. Pengu duhet të jetë qartë i specifikuar dhe i identifikueshëm. Për kredi mbi 20 mijë kërkohet edhe hipoteka, e cila duhet të mbulojë 150 % vlerën e

kredisë. Pronësia e hipotekës duhet të jetë qartë e definuar si dhe pronat duhet të kenë ndarje fizike të qartë në rast se ka më shumë se 1 pronar. Këto kredi përbëjnë risk të madh në raste kur nuk marrin parasysh kapacitetin e klientit dhe bazohen vetëm në madhësinë e kolateralit.

4) Si qëndron Kosova në raport me vendet e rajonit kur krahasojmë tregun e kredive të biznesit?

Në raport me vendet e tjera të rajonit, Kosova ka një shkallë më të vogël të kreditimit, pasi që si burim të financimit të këtyre kredive bazohen në depozita vendëse. Ky model i kreditimit siguron një stabilitet më të madh nga njëra anë, mirëpo nga ana tjetër, mungesa e burimit shtesë të kapitalit pamundëson qasjen në kredi dhe shfrytëzimin e plotë të potencialeve.



KREDITË E BIZNESIT NË KOSOVË TË NJËJTA ME ATO NË RAJON

ARTOR BERDYNA

DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË SHITJES,
BANKA PËR BIZNES

1) Cilat janë kushtet që duhet plotësuar për t'u kualifikuar për marrjen e një kredie të biznesit?

Një klient për t'u kualifikuar për të marrë kredi të biznesit në BPB duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë të regjistruar biznesin në MTI,
- Biznesi të jetë funksional, d.m.th. të krijojë të hyra dhe të jetë atraktiv,
- Gjatë 6 muajve të fundit të ketë qarkullim nëpërmes llogarisë bankare,
- Të ketë histori të mirë bankare, sidomos në kthimin e kredive dhe të financimeve të tjera,
- Të ketë biznes plan të qartë (destinimi i financimit),
- Të krijojë të hyra të mjaftueshme për kthimin e anuiteteve apo financimin (mbitërheqjen, biznesin dokumentar),
- Nga të hyrat e krijuara të ketë mundësi të zhvillojë biznesin,
- Që të ketë një menaxhment që e di si të udhëheqë biznesin dhe e di se ku duhet të shkojë pas disa vjetëve, etj.

2. Si variojnë normat e interesit për këtë lloj të kredive? A ekziston mundësia të intervenohet në normën e interesit të aplikuar? Sa është

het në normën e interesit të aplikuar? Sa është shuma e lejuar e kredive të biznesit (si variojnë ato)?

Normat e interesit për kredi biznesi variojnë nga 9.8 deri në 12.5 % dhe ato varen nga:

- Destinimi i kredisë,
- Lloji i kredisë,
- Maturiteti i kredisë,
- Bashkëpunimi i klientit me BPB-në

Varësisht nga bashkëpunimi i klientit me BPB-në këshilli i lejitimit të kredive mund të vendosë që një klienti t'i lejojë kredi me interes jashtë normave standarde të publikuara. Pra, te klientët me interes për bankën, banka atyre mund t'u ofrojë kushte preferenciale për produkte dhe shërbime që ajo i ofron.

Shuma e lejuar e kredive të biznesit varet:

- Nga tipi i klientit (a është biznes i vogël, biznes i mesëm ose biznes korporatave);
- Nga biznesi plani i projektit që duhet të financohet, përkatësisht të mbështetet;
- Nga plani i krijimit të të hyrave të planifikuara;
- Nga mundësitë e kthimit të kredive, respektivisht nga niveli i zhvillimit të biznesit aktiv;

- Nga kërkesat rregullative dhe ligjore, etj.

3) Çka kërkohet për mbulesë të këtyre kredive? Çfarë lloj kolateral është i pranueshëm? Si kalkulohet risku për këto kredi dhe a përbëjnë këto kredi risk të madh?

Për çdo kredi që aprovohet kërkohet të ketë mbulesë për sigurim të kthimit të kredisë dhe kjo mbulesë mund të jetë:

- Hipotekë (tokë, shtëpi, lokal afarist, banesë) në lartësi minimum 100 % e shumës së kredisë, të cilat duhet të intabulohen në zyrën kadastrale;
- Para të gatshme, 100 % e shumës së kredisë (cash cover loan);
- Garanci nga ndonjë bankë tjetër që mbulon 100 % të shumës së kredisë;
- 4.) Si qëndron Kosova në raport me vendet e rajonit kur krahasojmë tregun e kredive të biznesit?

Përafërsisht kushtet e ofruara për kredi të biznesit në Kosovë janë të njëjta me ato në rajon.



PROCREDIT BANK DO TË VAZHDOJË TË JETË PARTNER LIDER I BIZNESEVE NË KOSOVË

BESNIK BERISHA

MENAXHER I LARTË, PROCREDIT BANK

1) Për çfarë qëllimi shërbejnë kreditë e biznesit?

ProCredit Bank në kuadër të shërbimeve të plota bankare përqendrohet në financimin e bizneseve nëpërmes kredidhënies dhe shërbimeve të tjera bankare të adaptuara në bazë të nevojave individuale të klientëve afaristë. Fokusi i bankës sonë në mbështetjen financiare të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është i bazuar në rëndësinë që kanë këto ndërmarrje në stimulimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë. Po ashtu, ne jemi të bindur se këto biznese krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës. Prandaj, ProCredit Bank krahas shërbimeve cilësore për klientët privatë, përqendrohet në financimin e bizneseve në Kosovë. Qëllimi i kredive të biznesit është që t'i plotësojnë nevojat financiare të afaristëve në raport me menaxhimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të biznesit të tyre. Ne i mbështesim afaristët kosovarë edhe kur ata dëshirojnë ta zgjerojnë biznesin ekzistues në një biznes tjetër të ri, të rrisin profitin, apo të fillojnë

prodhimin. Është e rëndësishme të veçojmë qasjen e bankës sonë në financimin e bizneseve vendëse për të bërë investime afatgjate. Në këtë kontekst, ProCredit Bank është partneri lider me qëllim që t'iu mundësohet bizneseve të jenë të suksesshme, të përfitojnë nga shërbimet e shpejta dhe shumë cilësore bankare dhe të ndërtojë bashkëpunim afatgjatë. Zyrarë të specializuar në menaxhimin e marrëdhënieve me klientë në ProCredit Bank këshillojnë klientët në mënyrë transparente dhe të bazuar në analizë të shëndoshë financiare. Kjo qasje e përgjegjshme na mundëson të ndërtojmë një marrëdhënie afatgjate të bazuar në besim reciprok.

2) Cilat janë kushtet që duhet plotësuar për t'u kualifikuar për marrjen e një kredie të biznesit?

Siç e përmenda, ProCredit Bank e bazon kredidhënien në analizë të shëndoshë financiare, duke ofruar trajtim individual të bazuar në nevojat individuale të secilit biznes. Kështu i bazojmë edhe kushtet që duhet plotësuar për t'u kualifikuar për të përfituar nga kreditë, mbitërheqja, linja kreditore, garancia bankare, kreditë kartelat për biznes, shërbimet elektronike bankare për bizneset, e të tjera. Për të sqaruar sesi zbatohet kjo në praktikë, do të tregoja për ofertën aktuale të ProCredit Bankës, në kuadër të së cilës ofrojmë shërbimin Limiti Kreditor, i dizajnuar për t'i plotësuar nevojat financiare të bizneseve. Vlera e limitit kreditit përcaktohet në bazë të vetëm një analize (analizë që banka e bën pa pagesë), ku vlerësohet potenciali kreditor i një biznesi. Shuma e aprovuar e limitit kreditor varet nga potenciali i atij biznesi dhe pastaj ajo shumë mund të shfrytëzohet kurdo që klienti ka nevojë brenda një periudhe kohore. Pra, Limiti Kreditor mund të shfrytëzohet në mënyrën që iu përshtatet më së miri vetë bizneseve.

Shumat e kredive për biznese variojnë prej disa mijëra euro deri në disa milionë, gjithnjë duke vepruar në pajtueshmëri me normat e interesit të aplikuar? ProCredit Bank aplikon norma konkurruese për kredi biznesi. Ne vazhdimisht kemi ulur normat e interesit në kredi dhe si rezultat i këtij trendi, normat kanë shënuar zbritje graduale. Ky lehtësim për bizneset vendëse është bërë për të mbështetur dhe stimuluar afaristët kosovarë në zgjerimin e bizneseve të tyre. Ulja e kamatave në ProCredit Bank është po ashtu rezultat i përvijës së krijuar me klientët pas një relacioni më të gjatë dhe njohje më të mirë me aktivitetet e tyre, edhe duke intervenuar në normën e interesit. Gjithashtu është me rëndësi të dihet se norma të ndryshme interesi aplikohen në kredidhënie varësisht prej shumës së kredisë, kohëzgjatjes së kthimit të kredisë, si dhe për çfarë lloj investimi do të përdoret kredia. Shumat e kredive për biznese variojnë prej disa mijëra euro deri në disa milionë, gjithnjë duke vepruar në pajtueshmëri me normat e interesit të aplikuar? Sa është

3) Si variojnë normat e interesit për këtë lloj të kredive? A ekziston mundësia të intervenohet në normën e interesit të aplikuar? Sa është

shuma e lejuar e kredive të biznesit (si variojnë ato)?

ProCredit Bank aplikon norma konkurruese për kredi biznesi. Ne vazhdimisht kemi ulur normat e interesit në kredi dhe si rezultat i këtij trendi, normat kanë shënuar zbritje graduale. Ky lehtësim për bizneset vendëse është bërë për të mbështetur dhe stimuluar afaristët kosovarë në zgjerimin e bizneseve të tyre. Ulja e kamatave në ProCredit Bank është po ashtu rezultat i përvijës së krijuar me klientët pas një relacioni më të gjatë dhe njohje më të mirë me aktivitetet e tyre, edhe duke intervenuar në normën e interesit. Gjithashtu është me rëndësi të dihet se norma të ndryshme interesi aplikohen në kredidhënie varësisht prej shumës së kredisë, kohëzgjatjes së kthimit të kredisë, si dhe për çfarë lloj investimi do të përdoret kredia. Shumat e kredive për biznese variojnë prej disa mijëra euro deri në disa milionë, gjithnjë duke vepruar në pajtueshmëri me normat e interesit të aplikuar? Sa është

KOMPONENTA E PERFORMANCËS
SË KREDISË DHE KOLATERALI

**JOHANNES
RIEPL**
ANËTAR I BOR-
DIT MENAXHUES,
PËRGJEGJËS PËR
KORPORATA
RAIFFEISEN BANK
KOSOVË

1) Cilat janë kushtet që një biznes duhet të përbushë që të jetë i kualifikuar për kredi biznesi?
Një biznes duhet të ketë një afat të gjatë të qëndrueshmërisë në biznes, në mënyrë që të kualifikohet për kredi biznesi në Bankën Raiffeisen në Kosovë.

2) Si ndryshojnë normat e interesit për këto lloje të kredive? A ekziston mundësia për të ndërhyrë në normën e interesit? Cila është shuma e lejuar për kredi të biznesit (si ndryshojnë ato)?
Normat e interesit varen nga disa faktorë: historia kreditore, kohëzgjatja, struktura dhe kolaterali, etj., të gjitha janë të rëndësishme. Komponenta e performancës së kredisë, sikurse (historia kreditore, transparenca, qarkullimi mujor) po ashtu merret parasysh. Cilido nga këta faktorë ndikon dukshëm në normën e interesit.

3) Çfarë mbulese kërkohet për këto kredi? Çfarë lloj pengu (garancie) është i/e pranueshëm/me? Si llogaritet risku për këto kredi dhe a paraqesin këto kredi risk kreditor?
Pengu varet nga lloji i kre-

disë. Për kredi investimi, çfarëdo lloji i pasurisë së paluajtshme ose i pajisjeve pranohet. Për lizing, objekti i marrë me qira zakonisht lihet si kolateral/peng. Për komisionimin e borxheve të këqija llogaritet e arkëtueshme pranohen si peng/kolateral.

4) Ku qëndron Kosova me kredi të biznesit në krahasim me vendet e rajonit?
Disa lloje të kredive nuk ofrohen fare ose janë të nënpërfaqësuar në Kosovë. Produkte të tilla, si: blerja e banesës/apartamentit, duke e futur atë në hipotekë (Lizing-u), komisionimi i borxheve të këqija (Factoring-u) dhe financimi i strukturuar i tregtisë ende nuk janë në nivelin e vendeve fqinje ose nuk janë fare në dispozicion. Banka Raiffeisen në Kosovë ka ofruar produktin e Leasing-ut me sukses tani pesë vjet dhe në vitin 2013 do të fillojë edhe ofrimin e dy produkteve të tjera. Tregjet e borxheve/obligacioneve (p.sh. letrat me vlerë të korporatave) nuk janë ende në dispozicion. Produkte të tjera janë në dispozicion nga të gjitha bankat në Kosovë dhe janë në nivel cilësor në krahasim me vendet e tjera fqinje.

TREGU I KREDIVE TË BIZNESIT
NË KOSOVË KA NJË RËNDËSI TË
VEÇANTË**OSMAN OSMANI**

DREJTOR I DIVIZIONIT TË KORPORATAVE, NLB PRISHTINA

1) Cilat janë kushtet që duhet plotësuar për t'u kualifikuar për marrjen e një kredie të biznesit?

Për t'u kualifikuar për marrjen e një kredie të biznesit duhet të plotësohen këto kushte:
a) Biznesi të jetë i regjistruar në Kosovë dhe të ketë së paku 6 muaj të zhvillimit të suksesshëm të veprimtarisë.
b) Të jetë i licencuar për zhvillimin e veprimtarisë (nëse kërkohet me ligj).
c) Të ketë të hapur llogarinë në NLB Prishtina dhe të ketë qarkullim nëpërmes saj.
d) Të ketë histori të mirë kreditore (nëse ka pasur kredi më parë).
e) Të ketë rrjedhë të mirë të parasë dhe aftësi kreditore.
f) Të ketë arsyeshmërinë e kërkesës kreditore.
g) Të ketë kolateral (peng apo hipotekë) nëse është e nevojshme (varësisht prej shumës së kërkesës).

2) Si variojnë normat e interesit për këtë lloj të kredive? A ekziston mundësia të intervenohet në normën e interesit të aplikuar? Sa është shuma e lejuar e kredive të biznesit (si variojnë ato)?

Varësisht prej qëllimit dhe llojit të produktit kreditor, normat e interesit për kredi të biznesit variojnë nga 1.5% e deri në 13.8% vjetore. Deri në përfundimin e kontratës nuk ekziston mundësia e intervenimit në normat e interesit të aplikuara më parë (te kreditë aktive), me përjashtim të ndonjë kontrate specifike. Shuma minimale që mund të lejohet për kredi të biznesit është 200 euro, kurse shuma maksimale varet nga aftësia kreditore e klientit, qarkullimi me NLB Prishtina, qëllimi i kredisë si dhe mbulesa me kolateral.

3) Çka kërkohet për mbulesë të këtyre kredive? Çfarë lloj kolaterali është i pranueshëm? Si kalkullohet risku për këto kredi dhe a përbëjnë këto kredi risk të madh?
Për mbulesë të kredive të biznesit kërkohet peng dhe hipotekë, varësisht prej shumës së kredisë. Për kredi të deri 30.000 euro kërkohet vetëm peng (mjetet e punës, makina, vetura, kamion etj.), i cili duhet të jetë i vlefshëm, kurse për shumat mbi 30.000 euro kërkohet peng dhe hipo-

tekë (toka dhe objektet e biznesit, shtëpitë si dhe pronat e tjera të paluajtshme, të cilat kanë vlerë). Në kalkulimin e riskut për kredi të biznesit ndikojnë disa faktorë, si: forma organizative e ndërmarrjes, veprimtaria, detyrimet, struktura e pronësive, vlera e ndërmarrjes, madhësia e ndërmarrjes, pozita e mëparshme dhe ajo e parashikuar në treg, kapitali, likuiditeti i ndërmarrjes, aftësia kreditore, kolaterali, menaxhimi, legjislacioni vendës, efikasiteti i gjyqësorit, etj. Duke marrë parasysh të gjithë këta faktorë, mund të konstatohet se kreditë e biznesit përbëjnë një risk mjaft të lartë.

4) Si e karakterizoni tregun e kredive biznese në Kosovë? Cilat janë përparësitë dhe të metat e tregut të kredive të biznesit në Kosovë?
Tregu i kredive të biznesit në Kosovë ka një rëndësi të veçantë, këtë e dëshmon edhe vetë pjesëmarrja e mbi 60% të kredive të biznesit në totalin e kredive në vend, gjithashtu duke pasur parasysh që bizneset vendëse janë promotori i zhvillimit ekonomik të vendit. Kreditë e bizne-

sit ndikojnë në zhvillimin e vazhdueshëm të ndërmarrjeve, duke iu mundësuar atyre të kenë pozitë më të mirë financiare, që të jenë në hap me kohën, të jenë më konkurrenë në treg, të dalin me produkte të reja, të krijojnë vende të reja pune dhe t'i plotësojnë kërkesat e tyre për biznes. Në këtë mënyrë bëhet rritja dhe zhvillimi i bizneseve, të cilat drejtpërdrejt ndikojnë edhe në ngritjen e zhvillimit ekonomik të vendit. Si përparësi e tregut të kredive të biznesit në Kosovë janë: mundësia e qasjes më të lehtë financiare nga ana e bizneseve, ndikimi direkt në zhvillimin e ndërmarrjeve si dhe ndikimi indirekt në zhvillimin ekonomik të vendit. Kurse si dobësi e tregut të kredive të biznesit në Kosovë janë risku i lartë kreditor, jotransparenca e pasqyrave financiare të bizneseve si dhe ekonomia joformale, ku të gjithë këta faktorë ndikojnë edhe në koston e këtyre kredive.

VAZHDIM NGA FAQE 32

me rregulloret e vendit për kapitalin. Normat konkurruese në kredi biznesi ofrohen krahas një sërë lehtësish të tjera për komunitetin e bizneseve, duke iu mundësuar atyre periudhë të kthimit të kredisë deri në 10 vjet, investime afatgjate, vendimmarrje të shpejtë të bazuar në analizën individuale të bizneseve si dhe lehtësi të tjera për këtë sektor.

4) Çka kërkohet për mbulesë të këtyre kredive? Çfarë lloj kolaterali është i pranueshëm? Si kalkullohet risku për këto kredi dhe a përbëjnë këto kredi risk të madh?
ProCredit Bank aplikon qasje mjaft fleksibile për sa u përket garancive të kërkuara. Për shembull, nëpërmes ofertës aktuale për kredi biznesi ofrojmë kredi deri në shumën 50 mijë euro edhe pa hipotekë.

5) Si e karakterizoni tregun e kredive biznese në Kosovë? Cilat janë përparësitë dhe të metat e tregut të kredive të biznesit në Kosovë?
Ky treg është i karak-

terizuar me konkurrencë dhe shumë sfida. Mirëpo, ne në ProCredit Bank jemi krenarë që kemi luajtur rolin lider në zhvillimin e tregut të kredive të biznesit në Kosovë dhe rezultatin e tyre në ekonominë e Kosovës. Me kreditë tona për klientët afaristë shumë biznese kanë realizuar projekte të mëdha, kanë zgjeruar kapacitetin e tyre biznesor dhe njëkohësisht kanë shtuar numrin e të punësuarve. Me shumë përkushtim do të vazhdojmë të jemi partneri lider i bizneseve në Kosovë, gjithnjë duke u bazuar në misionin dhe orientimin e bankës sonë kah kreditë zhvillimore, e jo ato konsumuese

MULTIMEDIA &
EVENT MANAGEMENTWWW.GISHTAT.COM
INFO@GISHTAT.COM

RR HALIL ALI DEMAJ LOK Z. 1 PRISHTINË



EDUKIMI BANKAR, NË HAP ME ZHVILLIMET

ARBEN SALIHU

MENAXHER I TRAJNIMEVE
SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

Edukimi profesional bankar, krahas faktorëve të tjerë, është një ndër shtytësit kryesorë të zhvillimit të këtij sektori në Kosovë.

Me zhvillimet e fundit në fushën e financave, shtrohet pyetja sesi po ndikojnë këto ndryshime edhe në fushën e edukimit profesional në sektorin e financave. Fillimi i emetimit të letrave me vlerë dhe miratimi i "Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare" në gjysmën e parë të këtij viti, janë dëshmi të zhvillimit dhe të një lëvizjeje për avancimin e sektorit edhe më tej. Kjo natyrisht se ndikon edhe në zhvillimin e aktiviteteve dhe operacioneve bankare, si dhe në ndryshimin e taktikave, eventualisht.

Këto ndryshime dhe risi në sektor kanë ndikuar edhe në ndryshimin e përqendrimit të Qendrës për Trajnime Bankare në qasje si dhe në prioritete të temave të trajnimeve. Qendra për Trajnime Bankare, duke qenë tashmë një ndër bartësit më të mëdhenj të edukimit bankar në sektor, edhe gjatë vitit 2012 ka pasur një program të zhvilluar në bashkëpunim me anëtarët, duke u bazuar në ndryshimet dhe situatën e sektorit financiar. Disa trajnimeve të dakorduara nga viti i kaluar u ishin shtuar edhe disa tema të tjera që ndërlidheshin me këto ndryshime. Legjislacioni i ri për bankat ka ndikuar që të merren parasysh çështje, si auditimi dhe kontrolli i brendshëm, menaxhimi dhe raportimi i risikut, zhvillimi gradual i një tregu sekondar të letrave me vlerë, etj.

Zyrtarë dhe menaxherë të ndryshëm nga bankat dhe sektori mikrofinanciar kanë ndjekur trajnime, si Auditimi dhe Kontrolli i Brendshëm, Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), aplikimet financiare në MS Excel, trajnime të avancuara në taktikë, lidhshmëri, zhvillim dhe menaxhim i ekipeve.

Gjatë vitit 2012 në Qendrën për Trajnime Bankare deri në fillim të muajit nëntor kanë ndjekur trajnime më

shumë se 120 individë, shumica nga sektori bankar dhe financiar. Përderisa, në gjysmëvjetorin e parë të 2012-ës, trembëdhjetë individë janë certifikuar në programin EFCB, ndërsa 14 të tjerë aktualisht janë duke ndjekur kursin përgatitor për certifikim, i cili do të ndodhë në muajin mars 2013.

Qasje e re

Sikur në shumë vende që tashmë janë duke kaluar nëpër këto ndryshime, edhe në Kosovë njeriu po fillon të shihet si burimi kryesor i suksesit të një institucioni financiar. Me këtë parasysh dalin çështje sesi të avancohet personeli përtej dogmave teorike dhe praktikave të deritashme të menaxhimit. Këtë vit mund të themi se Qendra për Trajnime Bankare ka adoptuar një qasje të re në trajnimet e përgjithshme, duke shtuar aspektin njerëzor dhe atë të personalitetit në trajnimet që ndërlidhen me menaxhim dhe lidhshmëri.

Nëpërmjet të kuptuarit të natyrës njerëzore dhe personalitetit, të aspekteve personale të komunikimit në punë dhe ndikimit të shprehive individuale në kulturën e punës, mund të jemi më efikas në punën tonë dhe të tejkalojmë disa nga problemet me shumë lehtësi. SHBK ka aplikuar risi në disa fusha të trajnimeve, të cilat janë në hap me zhvillimet botërore të aftësisë profesionale dhe personale të stafit. Sidomos në aspektin e zhvillimit të qasjes me njerëzit, Qendra për Trajnime Bankare ka mbajtur dy programe me fokus personalitetin, dinamikën e grupeve, konfliktet dhe thashethemet, si dhe aplikimin e këtyre njohurive në menaxhim dhe lidhshmëri, përfshirë edhe implikime të tjera.

Trajnimi "Lidhshmëri dhe formimi i ekipeve" i mbajtur në muajin maj nga eksperti belg, Jean-Yves Neu, është përqendruar në qasje të personalitetit gjatë menaxhimit të stafit apo ekipeve të ndryshme, si ndikojnë tipat e ndryshëm në kryerjen e detyrave me natyrë të ndryshme, si ndikon personaliteti në komunikim ekipor, si të njihet personaliteti i bashkëbiseduesit në negociata dhe si të eksploatohen këto njohuri për të ngritur kohezion brenda ekipeve dhe stafit. Programi bazohet sipas metodologjisë Myers Briggs Type Indicator (MBTI), që është një sistem për kategorizim të



- **Kredi Individuale**
 - Kredi Konsumuese
 - Kredi Kesh
 - Kredi për Edukim
- **Kredi për Biznes**
- **Kredi për Blerjen e Banesave dhe Lokaleve Afariste**
- **Kredi për Bujqësi dhe Blegtori**
- **Kredi për Blerjen e Veturave**
- **Kredi Suazore**

Ne njohim rrugën tuaj...

Adresa: Rr. Rexhep Luci nr.2
10000 Prishtinë - KosovëTel: +381 (0) 38 244 548
Fax: +381 (0) 38 233 224info@lesnaif.com
www.lesnaif.com



personalitetit duke u bazuar në teoritë e Karl Jungut. Pjesëmarrësit ishin të kënaqur me njohuritë e reja të fituara, të cilat do t'i përdorin në punët e ndryshme ditore të menaxhmentit. Trajnimi është ndjekur nga zyrtarë dhe udhëheqës të fushave të ndryshme në sektorin bankar.

"Aftësitë menaxheriale – qasje psikologjike", është trajnimi tjetër i cili ka ofruar njohuri që janë mjaft aktuale, mirëpo të paprekura deri më tash në fushën e trajnimeve profesionale në vendin tonë. Pjesëmarrësit patën rastin të njihen me personalitetin e tyre dhe si ndërlidhet kjo me rezultatet e tyre në punë; pse ata janë më të aftë në disa punë dhe më të ngathët në disa punë të tjera; si të identifikojnë personalitetin të kolegët, aplikuesit për punë dhe menaxhmenti dhe si të komunikojnë me llojet e ndryshme të personaliteteve.

Partneriteti ndërkombëtar në trajnime

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe përkrahja teknike nga disa institucione ndërkombëtare të edukimit dhe zhvillimit bankar ka mundësuar zhvillimin e standardeve dhe politikave të trajnimit në hap me ato të vendeve të zhvilluara.

Me Bankën Botërore, tashmë gjashtë vjet, SHBK organizon trajnime të nivelit të lartë me ekspertë të shquar ndërkombëtarisht në fushat respektive të

ekspertizës, duke mundësuar kështu që të jemi më të përgatitur për tregjet ndërkombëtare dhe të japim kontributin tonë në anëtarësimet dhe inkuadrimet ndërkombëtare.

Po ashtu, Qendra për Trajnime Bankare në partneritet me Agjencinë për Transfer të Teknologjisë Financiare (ATTF) në Luksemburg i mundëson personelit të anëtarëve tanë të certifikohen dhe të aftësohen në fusha të ndryshme të bankave dhe financave. Gjatë këtij viti trajnime dhe certifikime jashtë vendit kanë ndjekur më se dhjetë persona dhe pritet të ndjekin edhe gjashtë të tjerë deri në fund të vitit.

SHBK është anëtare e akredituar edhe në Rrjetin Evropian për Trajnime Bankare dhe Shërbime Financiare (European Banking and Financial Services Training Network – EBTN). Si rezultat i këtij bashkëpunimi është zhvilluar edhe programi i Certifikimit Ndërkombëtar EFCB – me përkrahjen e agjencisë USAID / KPEP – që tashmë ka filluar aftësimin dhe certifikimin e studentëve për njohuri të përgjithshme bankare. Përveç certifikimit EFCB, Shoqata e Bankave të Kosovës ndjek zhvillimet e reja në Evropë dhe botë duke marrë pjesë në mbledhjet e rregullta të anëtarëve dhe të gjitha takimet në kuadër të angazhimeve tona edhe në projekte të tjera që do të sillnin dobi për sektorin bankar dhe financiar në Kosovë.

PROGRAMI I CERTIFIKIMIT EFCB (BAZAT E AFARIZMIT BANKAR) I SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS - SUKSES I RËNDËSISHËM NË ZBATIMIN E PROGRAMIT TË USAID-IT PËR NDËRMARRJET PRIVATE NË KOSOVË



MAURY WRAY
BRIDGES

SHEFE E PROGRAMIT,
USAID KPEP

Dhjetori shënon përfundimin e projektit të madh të US-AID-it, i cili ishte i përqendruar në zhvillimin e sektorit privat në Kosovë. Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë (KPEP) prej 21.870.000 dollarësh kishte në fokus mbështetjen e sektorëve të synuar (përfshirë ndërtimtarinë, bujqësinë, përpunimin e drurit, teknologjinë e informimit dhe komunikimit (ICT), si dhe turizmin), shërbimet mbështetëse për bizneset, përmirësimin e mjedisit afarist, si dhe zhvillimin e fuqisë punëtore. Partneriteti i KPEP-it me Shoqatën e Bankave të Kosovës (SHBK) ilustron mbështetjen në sferën e shërbimeve të biznesit, duke siguruar kështu zotësi për shoqatat, si dhe zhvillim të fuqisë punëtore.

Zhvillimi i fuqisë punëtore luan rol kyç në forcimin e ekonomive të të gjitha kombeve, përfshirë këtu edhe Kosovën. Duke u nisur nga fillimi i projektit në vitin 2008, strategjia e programit KPEP të USAID-it për zhvillim të fuqisë punëtore në Kosovë përfshinte identifikimin e aftësive të nevojshme në ekonomi dhe pastaj futjen e tyre në një program mësimor të nxitur nga kërkesa, trajnime dhe programe praktike për zhvillim të aftësive, përmirësimin e kapaciteteve institucionale në institucione të ndryshme të përfshira në zhvillimin e fuqisë punëtore.

Në mesin e këtyre institucioneve ishte edhe Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK), një industri që ndan qëllimin e njëjtë të KPEP-it për promovimin e zhvillimit afatgjatë ekonomik të Kosovës. "Ne ishim të kënaqur që mbështetëm këtë program me SHBK-në", tha znj. Maury Wray Bridges, drejtore e Programit, "pasi që ky është një shembull konkret i sjelljes së standardeve të njohura

ndërkombëtare të cilësisë për rritjen e konkurrencës së fuqisë punëtore në Kosovë".

Për të përbushur këtë qëllim, programi KPEP i US-AID-it i ka kontribuar me 73.000 euro Shoqatës së Bankave të Kosovës për të nisur programin e certifikimit Bazat e Afarizmit Bankar (EFCB). Programi certifikon bankierë lokalë me standarde evropiane. Trajnimi dhe certifikimi iu ofron bankierëve zhvillim të karrierës në mënyrë të sigurt dhe me standarde të njohura evropiane. Programi iu mundëson pjesëmarrësve thellim të njohurive për mjedisin monetar dhe ekonomik në të cilin veprojnë bankat evropiane, konsumatorin, nevojat për produkte dhe shërbime, si dhe bazat e marketingut, menaxhimin dhe etikën.

USAID-i mbështeti programin e EFCB të SHBK-së me qëllim që të bëjë diçka më shumë sesa vetëm të ndihmojë të punësuarit në industrinë bankare të Kosovës. Ajo ofroi asistencë me qëllim që kjo të shpaguehet për Kosovën vitet në vijim, sepse një fuqi punëtore e kualifikuar ndihmon në zgjerimin e punësimit, rritjen e konkurrencës së ekonomisë lokale, si dhe integrimin e vendit me pjesën tjetër të Evropës.

Deri më tani numri i studentëve të trajnuar dhe të akredituar ndërkombëtarisht është më shumë se 40, përfshirë këtu edhe punonjësit e bankave që ishin pjesëmarrës. Trashëgimia e punës së KPEP-it me Shoqatën e Bankave të Kosovës vazhdon nëpërmes programit të certifikimit EFCB që ajo ofron. Një grup prej 14 pjesëmarrësve ka filluar programin në tetor.

Puna e SHBK-së në përgatitjet për akreditimin e programit të saj të certifikimit nga Rrjeti Evropian për Trajnime Bankare ka ndihmuar që menaxhimi bankar dhe praktikant bankare të Kosovës të jenë të bashkërenduara me standarde ndërkombëtare dhe veçanërisht ato evropiane. USAID-i është krenar për ndihmën që i ka dhënë SHBK-së nëpërmes Programit për Ndërmarrje Private në Kosovë, për të shtyrë përpara rritjen e industrisë bankare në Kosovë si dhe ekonomisë në përgjithësi. Mësoni më shumë rreth asaj se si KPEP ka ndihmuar Kosovën në katër vjetet e saj të parë si shtet i pavarur, duke vizituar web faqen www.usaidkpep.org

Bazat e Afarizmit Bankar | EFCB

*European Foundation
Certificate in Banking*



fitoni njohuri dhe certifikatë bankare

krijoni vetes përparësi gjatë rekrutimit në banka

përfitoni nga certifikata e njohur ndërkombëtarisht



Mobile Banking Bëni pagesat tuaja në lëvizje shpejtë dhe sigurt - 24/7

Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit,
kontaktoni Qendrën e Trajnimeve në Shoqatën e Bankave të
Kosovës:

- 038 246 171
- kbatraining@bankassoc-kos.com
- www.bankassoc-kos.com



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKERS' ASSOCIATION



BANKA PËR BIZNES

mundësi për më shumë...

Të reja nga bankat

Kredi me vetëm 7% interes nga Banka Kombëtare Tregtare

BKT ka lansuar ofertën më të re, dhënien e kredisë personale me interesin më të ulët në treg, me vetëm 7%. Kjo është hera e parë që në Kosovë ofrohet një përqindje kaq e ulët interesi, por me anë të kësaj oferte BKT përpiqet t'iu afrohet sa më shumë kërkesave të qytetarëve të Kosovës, në mënyrë që t'i ndihmojë ata në plotësimin e nevojave të tyre.



Nga kjo ofertë mund të përfitojnë të gjithë të punësuarit në institucionet publike, të cilët e marrin ose e kalojnë pagën në BKT dhe mund ta përdorin atë për çfarëdo nevoje të tyre. Oferta përmban kredinë personale me shumë deri në 5.000 euro, me afat të kthimit të kredisë deri në dy vjet, pa shpenzime administrative dhe pa garantues. Gjithashtu të interesuarit mund të përfitojnë llogarinë 2 në 1 pa mirëmbajtje, duke përfituar 3 % interes, kartë debiti falas, kartë krediti Prima, pa mirëmbajtje vitin e parë, me mundësi pagese deri në 12 këste me 0 % interes (sipas marrëveshjes me tregtarin) si dhe mbiterheqje me limit deri në një pagë, pa shpenzime administrative.

Përfitoni nga oferta më atraktive në tregun Kosovor. Kredi me vetëm 7%.

BpB – banka e parë në rajon, e cila ka ofruar shërbimin Mobile Banking



Banka për Biznes, si banka e parë në rajon që ka ofruar shërbimin Mobile Banking, tani përkrah shërbimin e këtij produkti edhe për platformat ANDROID dhe IPHONE. Pra, kjo mundësi tani është e mundur për të gjithë telefonat që kanë GPRS ose WiFi dhe të gjitha platformat e tjera. Ne jemi veçanërisht të kënaqur që me këtë shërbim jemi në pozitë të mbështesim kërkesat specifike të një numri të madh të kosovarëve me standarde moderne botërore, tani lehtësisht të zbatueshme edhe në vendin tonë.

Mobile Banking ju lejon qasje të lehtë dhe të sigurt në llogarinë tuaj për të shikuar bilancin, shumën në dispozicion në kartelë, transferin e fondeve ndërmjet llogarive tuaja dhe palëve të treta nga celulari juaj. Me pak fjalë, kjo është struktura juaj e plotë bankare në majë të gishtave tuaj. Mobile Banking është në dispozicion në të gjitha rrjetet mobile.

Inovacion në tregun bankar

ProCredit Bank lanson platformën më të re të sigurisë për blerje në internet

Të gjithë klientët e ProCredit Bankës, të cilët posedojnë kartelën VISA (Classic, Globe, Enterprise), Maestro ose MasterCard, tash e tutje blerjet në Internet mund t'i realizojnë nëpërmjet platformës më të re 3-D Secure, gjë që mundëson blerje më të sigurta në Internet.



Ky shërbim i ri në tregun bankar të Kosovës mundëson blerje në Internet me numër personal iPIN, gjë që ofrohet për herë të parë për qytetarët e Kosovës, klientë të ProCredit Bankës.

Siguria e mjeteve në bankën më të madhe në vend gjithnjë vihet në rend të parë. Andaj, duke parë trendin e rritjes së blerjeve në Internet nga qytetarët e Kosovës, ProCredit Bank ka lansuar platformën 3-D Secure, e cila përforcon masat e sigurisë gjatë realizimit të pagesave/blerjeve në Internet.

Për të përfituar nga platforma 3-D Secure duhet të aplikohet për PIN Interneti (iPIN) në ndonjërin nga 150 bankomatët e ProCredit Bankës në Kosovë. iPIN është numër katërshifror që kërkohet gjatë blerjes në Internet në web faqe të ndryshme si mjet shtesë për konfirmim të blerjes.

Kështu, platforma 3-D Secure nëpërmjet iPIN-it u mundëson afaristëve dhe personave privatë të bëjnë blerje më të sigurta në Internet.

Pagesa e faturave nëpërmjet TEB-it

Për herë të parë në Kosovë Banka TEB u ofron klientëve të saj mundësinë për pagesën e të gjitha faturave në degët e TEB-it nëpërmjet kartelës Starcard me këste.

Nëpërmjet konceptit të saj inovativ dhe kreativ të zhvillimit të produkteve, Banka TEB ka lansuar shërbimin e pagesës për të gjitha institucionet publike dhe institucionet e tjera nëpërmjet kartelës 'Starcard' me këste, në të gjitha degët e TEB-it.



BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Nëpërmjet këtij shërbimi mund të bëni pagesën e faturave të ndryshme, si: faturave për energji elektrike, telefon, ujë, taksa, regjistrim të makinave, pagesat për kompani të sigurimeve, pagesat doganore, gjobat në trafik, si dhe të gjitha faturat e tjera.

Ky shërbim kontribuon në efikasitetin e procesit të mbledhjes së faturave në institucionet publike, si dhe ndihmon në stabilitetin e tyre financiar.

Për më tepër, klientët janë ata që do të përfitojnë më së tepërmi, sepse ata do të kenë mundësi që të ndajnë pagesat e tyre në këste dhe në të njëjtën kohë kursejnë kohën me anë të ekzekutimit të të gjitha transaksioneve të pagesave, në një vend të vetëm, Bankën TEB.

BKT kontribuon për shoqërinë



Banka Kombëtare Tregtare i ka kushtuar vëmendje të posaçme përgjegjshmërisë sociale, duke e konsideruar atë një prioritet të vazhdueshëm të saj. Si rezultat i kësaj, ajo herëpashere ka zhvilluar projekte të lidhura me mjedisin dhe komunitetin, në mënyrë që të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë dhe ndërgjegjësimin e saj për ruajtjen e ambientit.

Konceptit të Bankës Kombëtare Tregtare për përgjegjshmëri sociale në bazë të motos "Kontribuo për shoqërinë" i ka shërbyer ofrimi i produkteve dhe shërbimeve cilësore, krijimi i mundësive për punësim, sponsorizimi i vazhdueshëm i aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive dhe atyre të edukimit.

BKT ka dy vjet që është sponsor gjeneral i Superligës së Basketbollit të Kosovës, pjesëmarrës dhe sponsor i disa mbrëmjeve gala, fondet e grumbulluara të cilave kanë shkuar në dobi të fëmijëve të sëmurë, sponsor i Shoqatës së të Verbërve, sponsor i arsimimit të fëmijëve me rezultatet më të larta në kolegjin "Mehmet Akif", sponsor në përkrahje të nismës "Ta pastrojmë Kosovën", etj.

Rritja gjithnjë e më e madhe e BKT-së në Kosovë, e cila aktualisht operon me 23 degë, bazohet në qëllimin e saj strategjik që të bëhet banka numër një në ofrimin e produkteve financiare, duke vazhduar rritjen e pjesëmarrjes në treg, mbajtjen e pozicionit lider në shumëllojshmërinë e produkteve, teknologjive të reja, strategjive inovative dhe interesave të ofruara

Dita Botërore e kursimeve në ProCredit Bank

ProCredit Bank ka vazhduar traditën e shënimit dhe festimit të Ditës Botërore të Kursimeve më 31 tetor. Punonjësit e bankës i kanë kushtuar vëmendje të veçantë informimit dhe këshillimit të klientëve për kursimet dhe mënyrës sesi duhet kursyer, me qëllim të ngritjes së vetëdijes në mesin e qytetarëve për beneficionet e të kursyerit.

Me moton 'Gjëra të rëndësishme që duhet t'i dini për kursimet', shënimi i kësaj dite në Kosovë është shoqëruar me këshilla praktike sesi çdokush mund të kursejë, varësisht nga të ardhurat që ka.

Kursimet janë të rëndësishme, sepse ka momente në



jetë kur paratë nevojiten urgjentisht dhe ato ndihmojnë për të shmangur rrezikun e të qenit në borxh. Nuk është e nevojshme të kenë shumë para për të kursyer, është e mjaftueshme të ndani mënjane shuma të vogla parash, mirëpo në mënyrë të rregullt. Janë këto vetëm disa prej këshillimeve të shumta, për të cilat ProCredit Bank ka informuar klientët.

ProCredit Bank rregullon parqe në Prizren, Podujevë dhe Gjakovë

Në kuadër të fushatës mjedisore 'Është vendi ynë. Ta mbajmë pastër', ProCredit Bank ka rregulluar tri parqe në Prizren, Podujevë dhe Gjakovë, duke investuar në 72417 m² sipërfaqe publike. Vendosur në lokacione me frekuentim të lartë prej qytetarëve, këto tri parqe janë gjelbëruar dhe janë pajisur me ulëse e shporta.

Investimet e bankës në rregullimin e parqeve në njërin anë reflektojnë nevojën e më shumë hapësirave të gjelbra publike në Kosovë, si dhe në anën tjetër, kontributin në mjedis të një institucioni të përgjegjshëm financiar. Është shumë e rëndësishme që dhjetëra



fidanët e mbjella në Prizren, Podujevë, dhe Gjakovë të ruhen dhe të jenë në dispozicion edhe për gjeneratat e ardhshme. Prandaj, porosia e ProCredit Bankës është që ta mbajmë pastër ambientin që na rrethon, duke vepruar me përgjegjësi dhe duke mos e dëmtuar atë. Qasja e përgjegjshme në mbrojtjen mjedisore është pjesë përbërëse e përgjegjësisë shoqërore të ProCredit Bankës dhe vlerë e integruar në filozofinë tonë bankare.

ProCredit Bank mbledh qindra kapakë të plastikës, në ndihmë të njerëzve me aftësi të kufizuara

ProCredit Bank i është bashkuar iniciativës unike mjedisore në ndihmë të njerëzve me aftësi të kufizuara, duke mbledhur kapakë të plastikës që nga muaji maj 2012. Qindra kapakë janë duke u mbledhur për qëllime riciklimi, për të blerë karroca për nevojat e personave me



aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë mundësi t'i blejnë ato. ProCredit Bank me shumë kënaqësi i është bashkuar kësaj nisme të studentit kosovar në Turqi, Kushtrim Ahmeti, i cili ka kontribuar në ndryshimin e mënyrës sesi shikohet mbrojtja e mjedisit karshi ndihmës për njerëzit me aftësi të kufizuara. Kështu, nëpërmes kësaj iniciative kontribuojmë përtej mjedisit më të pastër, duke ndihmuar personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

TEB përkrahi konferencën "Fëmijët me autizëm"

Si gjithnjë, TEB Banka edhe këtë herë kontribuoi në çështjet shoqërore. TEB Banka këtë vit ka qenë sponsor i konferencës për "Fëmijët me autizëm", e cila është organizuar nga fondacioni "Fëmijët e Kosovës".

Në këtë konferencë pjesëmarrës kanë qenë drejtori gjeneral i Bankës TEB – Alp Yilmaz, presidentja e fondacionit "Fëmijët Shqiptarë" – znj. dr. Liri Berisha, zëvendëskryeministria e Kosovës, Edita Tahiri, ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani, përfaqësues nga Presidencia, nga Ministria e Arsimit, ambasadorë dhe përfaqësues nga vende të ndryshme, mjekë dhe prindër të fëmijëve me autizëm.

Qëllimi i kësaj konference ishte ngritja e vetëdijësimit dhe ndërgjegjësimin të opinionit të gjerë dhe organeve kompetente për problemet që lidhen me çregullimet e fëmijëve autistë, siç janë mundësitë për diagnostikim të hershëm të tyre, orientimin e drejtë të tyre, trajtimin dhe mbështetjen e prindërve që i kanë fëmijët me autizëm si dhe mundësinë e ngritjes së një qendre për fëmijët autistë në Kosovë, e cila do të ishte me rëndësi të madhe kombëtare.



Shoqata e Bankave të Kosovës përgjatë vitit 2012

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) ka kënaqësinë të prezantojë para jush aktivitetet, të cilat i ka zhvilluar gjatë këtij viti. Sikurse çdo vit tjetër, me një bashkëpunim edhe më të ngushtë Shoqata ka vazhduar të mbetet zë i rëndësishëm i industrisë bankare, nëpërmes përfshirjes dhe pjesëmarrjes në shumë diskutime dhe organizime të ndryshme, duke u bërë kështu përfaqësuese në mbrojtje të interesit të sektorit bankar dhe atij financiar, në veçanti, si dhe kontribuuese në zhvillimin ekonomik të Kosovës, në përgjithësi.

Shoqata e Bankave të Kosovës këtë vit ka qenë nismëtare e shumë aktiviteteve, nëpërmes të cilave ka ngritur bashkëpunimin dhe ka zgjuar vëmendjen për shumë çështje me interes. Ndër aktivitetet më të rëndësishme që janë zhvilluar gjatë këtij viti dhe që kanë kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, si në vetëdijësim, ashtu edhe në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes në Kosovë janë:

Panairi Financiar 2012

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) edhe këtë vit organizoi Panairin Financiar 2012, i cili u mbajt në hotelin Swiss Diamond në Prishtinë, më 27 dhe 28 shtator 2012. Në këtë panair morën pjesë të gjitha bankat komerciale që operojnë në Kosovë, anëtare të SHBK-së, institucione mikrofinanciare, kompani sigurimesh, kompani këshilluese të biznesit dhe ofruese të shërbimeve, kompani të teknologjisë informative dhe telekomunikimit si dhe kompani të dizajnit dhe produksionit.



Në vazhden e aktiviteteve të këtij panairi, u organizua edhe një konferencë me temën "Financimi për zhvillim", ku u vlerësua se sistemi bankar në Kosovë është i qëndrueshëm dhe ka arritur një nivel të lartë besueshmërie nga qytetarët. Në këtë panel të diskutimeve kishte përfaqësues të Bankës Botërore, të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe ekspertë të tjerë të ekonomisë nga akademja dhe sektori bankar në vend, të cilët vlerësuan se bizneset në Kosovë hasin në vështirësi të ndryshme, qoftë për shkak të mosfunksionimit të mirë të institucioneve në vend, por edhe nga vështirësitë e ndryshme të cilat hasen me rastin e financimit të tyre. Sfidat kryesore për financim në Kosovë përfshijnë mosregjistrimin e pronave në kadastrë, funksionimi jo i mirë i gjykatave si dhe jotransparenca e ndërmarrjeve në raportimin financiar.



Ndërsa, në forumin e organizuar me temën "E ardhmja bankare", fokus të veçantë në diskutime kishin produktet elektronike bankare. Në këtë panel të diskutimeve kishte përfaqësues të bankave komerciale në Kosovë, përfaqësues nga kompanitë më të mëdha në Kosovë që ofrojnë shërbime të teknologjisë informative, si dhe përfaqësues nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Në këtë forum u tha se Kosova ka një infrastrukturë të zhvilluar për përdorimin e produkteve elektronike bankare dhe se e ardhmja e shërbimeve bankare duhet të jetë e përqendruar në zhvillimet e fundit botërore, në shërbimet bankare nëpërmes telefonisë mobile, ndërsa sfida kryesore mbetet rritja e numrit të përdoruesve të këtyre shërbimeve.

Gjatë ditës së dytë të panairit u mbajt edhe forumi me temën "Financimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme" dhe "Rregullativa e industrisë financiare". Në këto forume u theksua se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe se problemet kryesore janë përdorimi i madh i parave të gatshme, shmangia nga tatimi, mosprezantimi i bizneseve nga ndërmarrjet, pasqyra financiare jo të besueshme, pasqyrat financiare të paaudituar, problemet me regjistrin e pengut dhe ato kadastrale, si dhe një sistem gjyqësor i çaluar. Ky forum është përkrahur nga Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM-ve), e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), duke iu bashkangjitur aktiviteteve të tyre të organizuara në kuadër

të Ditëve të Biznesit të Vogël – 2012, ku qëllimi është i njëjtë, promovimi dhe avancimi i ndërmarrjes si dhe përforsimi i dialogut ndërmjet palëve me interes.

Ndërsa, në forumin e dytë për rregullativën e industrisë financiare u pajtua se me aprovimin e "Ligjit për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione të tjera financiare jobankare", infrastruktura ligjore në Kosovë iu ka afruar standardeve ndërkombëtare të kërkuara sipas Basel II dhe Basel III. Gjithashtu u vlerësua se sistemi bankar është stabil dhe i qëndrueshëm, mirëpo ky stabilitet duhet të mirëmbahet nëpërmes përmirësimit të rregullativës në hap me zhvillimet globale

Takimi rajonal "Child & Youth Finance International"

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) në vazhden e përpjekjeve për të rritur edukimin financiar dhe për të vetëdijësuar publikun rreth sistemit bankar ka marrë pjesë në takimin rajonal Child & Youth Finance International për Evropë dhe Azi Qendrore që u mbajt në Bruksel më 6 dhe 7 nëntor 2012. Ky takim ka mbledhur në një vend ekspertë udhëheqës, praktikues dhe inovatorë nga gjithë rajoni, të cilët janë të angazhuar në çështje të qasjes në fi-



Konferenca "Tregjet regionale të kapitalit – mundësi të reja për firmat kosovare"

Më datën 15 nëntor 2012 u mbajt konferenca njëditore për Tregjet regionale të kapitalit në hotelin "Emerald" në Prishtinë. Kjo konferencë u organizua nga Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të Republikës së Kosovës dhe Departamentin e Thesarit Amerikan. Qëllimi i mbajtjes së kësaj konference ishte përfshirja e diskutimeve dhe prezantimeve nga ekspertët e regjionit lidhur me mundësitë dhe parakushtet për kompanitë kosovare për t'u qasur kapitalit në tregun regional ndërmjetësuese/brokerëve dhe kërkesat ligjore dhe rregulloret e duhura për emetimin e letrave me vlerë nga firmat e Kosovës. Në këtë konferencë ka pasur përfaqësues nga Bursa e Zagrebit, Bursa e Maqedonisë, përfaqësues nga Bursa e Tiranës dhe nga kompania shqiptare e brokerimit të licensuar 'AKSIONER International Securities Brokerage' në Tiranë, Shqipëri. Fjalime dhe analiza ka pasur edhe nga Bedri Hamza, ministër i Financave, Gani Gërguri, guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Robert Wright, kryetar i Bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës, Anne Schwartz nga Thesari Amerikan, Maureen Shauket, drejtore e Misionit të USAID-it në Kosovë dhe nga Leslie Sulenta, kryesuese e programit Partnerët për Stabilitet Financiar (PSF). Kjo konferencë shërbeu për të theksuar rëndësinë që tregjet e kapitalit kanë për zhvillimin ekonomik të vendit, angazhimin për të pasur një treg të shëndoshë financiar dhe një stabilitet makroekonomik dhe fiskal.

nancim dhe edukimin financiar për fëmijë dhe të rinj. Fokusi i këtij takimi ka përfshirë këto pika: Eksplorimi sesi ky edukim mund të arrijë në agjendat e trupave rajonale dhe politikëbërësit, deklarimi rajonal i politikëbërësve për edukimin financiar dhe përfshirja financiare për fëmijë dhe të rinj dhe theksimi i angazhimit të palëve të interesuara për të sjellë Child & Youth Finance në rajon. Kjo konferencë do të shërbejë pozitivisht edhe në Kosovë për të filluar një fushatë të organizuar nga SHBK-ja për të rritur edukimin financiar dhe për të ngritur vetëdijësimin e publikut sa u përket produkteve dhe shërbimeve bankare, si dhe funksionimin e sistemit bankar në përgjithësi. Pjesë e këtyre aktiviteteve janë edhe punëtoritë që do të mbahen me gazetarët e ekonomisë në Kosovë, të cilët mbulojnë ngjarjet e sektorit bankar në media. Ky qëllim synohet të arrihet nëpërmjet projekteve të ndryshme si pjesë e përpjekjeve globale dhe evropiane për të rritur edukimin financiar.



10

VJET NË KOSOVË

Banka Raiffeisen në Kosovë është degë e bankës austriake Raiffeisen Bank International AG (RBI). RBI erdhi në Kosovë në fund të vitit 2002 duke blerë pjesën më të madhe të aksioneve të Bankës Amerikane të Kosovës. Në qershor të vitit 2003, RBI u bë pronare e 100% të aksioneve dhe e emërtoi bankën si banka Raiffeisen në Kosovë.

Që nga atëherë, banka Raiffeisen ofron shërbime dhe produkte bankare për të gjitha kategoritë e klientëve: individë, biznese të vogla, biznese të mesme dhe korporata.

Kredi me vetëm



BEFASI
NGA BANKA ME OFERTAT
NR1 NË KOSOVË



Përfitoni nga oferta më atraktive në tregun Kosovar.
Kredi me vetëm 7%.



Qendra Kontaktuese
038 666 666

www.bkt-ks.com

Ne jemi gjithmonë këtu